

**BANESA E MUSTAFA  
SHEHUT  
ZERQAN - BULQIZË**



**PROJEKT  
RESTAURIMI**

RISHIKIM, 2022

MIRATOHET  
SEKRETAR K.K.T.K.M.

RUDINA ZOTO

GRUPI I PROJEKTIKIMIT:

Ark. Ronela Cuku  
Ark. Katerina Margariti  
Ark. Romir Mazari  
Ing. Zaim Lila

PERGJEGJES SEKTORI:

Ing. Klodjana Gjata



## Përmbledhja

|       |                                                                              |    |
|-------|------------------------------------------------------------------------------|----|
| 1     | VENDNDODHJA:                                                                 | 2  |
| 2     | PËRSHKRIMI HISTORIK:                                                         | 2  |
| 2.1   | TIPOLOGJIA E BANESËS                                                         | 2  |
| 2.1.1 | Vendbanime dhe banesa fshatare                                               | 2  |
| 2.1.2 | KRAHINAT E MASIVIT QENDRORË TË SHQIPËRISË VERIORE (zona e tretë tipologjike) | 3  |
| 2.1.3 | Vështrim i përgjithshëm historik e gjeografik                                | 4  |
| 2.1.4 | Karakteristikat e vendbanimit                                                | 4  |
| 2.1.5 | Mjediset e banesës dhe paisjet e tyre                                        | 4  |
| 2.1.6 | Analiza tipologjike                                                          | 6  |
| 2.1.7 | Trajtimi arkitektonik i banesës                                              | 7  |
| 2.1.8 | Teknika e ndërtimit                                                          | 8  |
| 3     | PËRSHKRIMI ARKITEKTONIK DHE GJENDJA EKZISTUESE:                              | 14 |
| 3.1   | Përshkrimi arkitektonik                                                      | 14 |
| 3.2   | Ndërrhyrjet ndërvitë                                                         | 18 |
| 3.3   | Gjendja ekzistuese dhe ndërrhyrjet e propozuara                              | 33 |
| 4     | OBJEKTIVAT                                                                   | 69 |
| 5     | DOKUMENTACIONI DHE BIBLIOGRAFIA:                                             | 69 |

## 1 VENDNDODHJA:

Banesa e Mustafa Shehut ndodhet në qendër të fshatit Zerqan, me kordinata geografike: 41°30'14.31"N / 20°21'26.05"E. Banesa mban statusin Monument Kulture kategoria e "I"-të, shpallur me Urdhëresë të Ministrisë së Arsimit dhe Kulturës datë 08.01.1977.




Figura 1. Ortofoto - Vendndodhja

## 2 PËRSHKRIMI HISTORIK:

### 2.1 TIPOLOGJIA E BANESËS

#### 2.1.1 Vendbanime dhe banesa fshatare

Ndërtimet për plotësimin e nevojave jetësore të fshatarësisë, e cila përbënte pjesën dërrmuese të popullsisë, zenë një vend të rëndësishëm në mbarë trashëgiminë ndërtimore të popullit shqiptar. Rrethanat historike gjatë periudhës, mesi i shek. XVIII deri në mesin e shek. XIX, kishin krijuar kushte të tilla, të cilat ndikuan fuqishëm në karakterin dhe tiparet e arkitekturës fshatare. Nevojat kryesore të jetës, plotësoheshin brenda një rrethi të mbyllur, që përfshinte, në radhë të parë, shtëpinë (banesën), fshatin (vendbanimin), e pastaj krahinën ose një grup krahinash. Ndër to, shtëpia ose banesa mbetet për një kohë të gjatë njësi bazë ekonomiko – shoqërore, e cila përmbushte kërkesat themelore materiale e shpirtërore të familjes fshatare. Prandaj edhe koncepti “shtëpi”, tradicionalisht përfshin të gjitha ndërtimet me funksion banimi

ose jo, kryesore e ndihmëse, të ngritura brenda territorit të oborrit. Përveç kësaj, ekonomia shtëpiake shtrihet edhe në territorin jashtë rrethimit të oborrit, si në kopështet, arat etj., mbi të cilat familja kishte të drejtën e plotë të pronës.

Një njësi tjetër e rëndësishme dhe e qëndrueshme është fshati ose vendbanimi, i kuptuar si një bashkësi territoriale me funksione ekonomiko - shoqërore dhe, në mënyrë të veçantë, me kufij të përcaktuar shumë qartë. Kufiri i fshatit përmbledh territorin e banuar dhe atë ekonomik, pronat individuale dhe ato të përdorimit kolektiv, për kullotë, dru etj.

Një njësi më e madhe territoriale është krahina, si bashkësi e shumë fshatrave me marrëdhënie të ngushta e të dendura ndërmjet tyre. Krahina karakterizohet nga organizimi i njëjtë shoqëror dhe ekonomik, nga mënyra e njëjtë e jetesës, nga prodhimi i përbashkët kulturor, si rezultat i bashkëjetesës shekullore në një zonë të caktuar gjeografike. Lidhje të shumta, siç ishin shkëmbime ekonomike, organizime shoqërore, lidhje martesore etj, bashkonin krahinat me njëra-tjetrën, duke krijuar bashkësi më të mëdha territoriale. Nga ana tjetër, një sërë faktorësh të tjerë historik, ekonomikë e shoqërorë, gjeografikë, do të pengonin shtrirjen e pa kufizuar të procesit të njësimi të traditave kulturore. Të gjitha këto tipare kanë ndikuar në mënyrën e jetesës dhe, për pasojë, në tiparet urbanistike dhe arkitektonike të vendbanimeve dhe të banesave. Veprimi i tyre ka bërë që në një territor kaq të vogël si Shqipëria, të ndeshemi me një shumëllojshmëri formash dhe zgjidhjesh arkitektonike.

Për këtë arsye duke u bazuar në kriterin kryesor të klasifikimit tipologjik, atë të kompozimit planimetrik-vëllimor, është bërë një farë ndarje në gjashtë nënzona, ku secila prej tyre ka krahina me tipare thelbësore tipologjike të njëjta. Ndarja tipologjike në nënzona krijon edhe një pasqyrë të plotë të shtrirjes gjeografike të këtyre grupeve.

### 2.1.2 KRAHINAT E MASIVIT QENDROR TË SHQIPËRISË VERIORE (zona e tretë tipologjike)




Figura.2- Krahina e masivit Qendror

### **2.1.3 Vështrim i përgjithshëm historik e gjeografik**

Masivit qendrorë i Shqipërisë së Veriut është një ndër grupet më të mëdha tipologjike, që përfshin një numër shumë të madh krahinash. Në këtë grup bëjnë pjesë krahinat e Matit, Dibrës, Çermenikës, Martaneshit, Malësia e Tiranës, Malësia e Krujës, dhe një pjesë e Mirditës. Numri i madh i krahinave që formojnë këtë grup, me kushtet gjeografike dhe e zhvillimin ekonomik e shoqëror jo gjithkund të njëjta, ka kushtëzuar që brenda këtij uniteti të spikatur kulturor të shfaqen edhe specifika dalluese për çdo krahinë. Karakteri i ndryshimit të relievit ndër këto krahina, kushtëzoi edhe një karakter të ndryshëm të ekonomisë. Disa krahina apo vendbanime ishin të shtrira përgjate luginave të lumenjëve në kushte të favorëshme për zhvillimin e buqësisë, ndërsa në krahina malore ekonomia bazë mbetej blegtoria. Kërkesat që lindin nga kushte të tilla jetese përcaktonin edhe mënyrën e të banuarit dhe për pasojë edhe tiparet urbanistiko-arkitektonike. Faktorët shoqëror e politik nuk ishin të pa përfillshëm në formimin e tipareve kulturore. Në këto kushte traditat malore mbeten më të pastra, ndërsa në ato fushore takohen edhe me përzierjen e ndikime të huaja.

### **2.1.4 Karakteristikat e vendbanimit**

Si pasojë e relievit të thyer, shpërndarja edhe dendësia e vendbanimeve nuk ka qenë uniforme në të gjithë territorin. Vendbanimet ngrihen në zona ose pellgje, të cilat kanë një pozicion të mbrojtur natyror. Ndarja e vendbanimeve në lagje, ku secila prej tyre zë një territor të veçantë, është tipari më i përgjithshëm urbanistik. Arsyet e veçimit të fshatit janë të shumta. Shpesh lagjet mbajnë emër familjesh që do të thotë që çdo lagje ka në zanafillën e vetë një ose disa familje me lidhje farefisnore. Në shumë raste vëndasit njohin si më të vjetër, nga zuri fill fshati, një bërthamë ose një lagje të caktuar të vendbanimit. Me rritjen e popullsisë qoftë nga shtesat natyrore, qoftë nga të ardhurit, bërthama e vjetër zgjerohet.

Fshati ose lagjet përshkoheshin nga një ose disa rrugë, nga të cilat degëzohen rrugica që lidhin me njëra-tjetrën të gjithë njësit e banuara. Përgjithësisht, rrugët ishin të pa shtruara, por nuk mungojnë rastet kur ato shtroheshin me kalldëm. Rrugët kufizoheshin nga gardhet e oborreve e të kopështevë ose nga muret rrethuesë të tyre. Nuk mungojnë gjatë këtyre rrugëve edhe element të tillë funksional si çezma e kroje. Një element tjetër i rëndësishëm ishin edhe qendra shoqërore e fshatit. Aty tradicionalisht bëheshin edhe mbledhjet për çështjet e ndryshme, sipas zakoneve të vëndit. Këtu ngriheshin gjithashtu ndërtesat e kultit, kishat dhe xhamitë.

### **2.1.5 Mjediset e banesës dhe paisjet e tyre**

Banesat e krahinave të grupit qendror të Shqipërisë Veriore përgjithësisht nuk dallohen për numër të shumë kthinash. Për këtë arsye, përmasat e mjediseve ishin të mëdha dhe pëmbushnin disa funksione, por duke dalluar gjithnjë funksionin kryesor, prej nga edhe kthina merte emrin.

Si zakonisht në banesat fshatare mjedisi më i rëndësishëm është *shtëpia e zjarrit*. Këtë rëndësi ajo e ruan në të gjitha fazat e zhvillimit të banesës. Shtëpia e zjarrit, që më vonë është një kthinë e vetme, përgjithësisht në katin e parë të banesës, ishte një ambjent i madh i shtruar me baltë dhe her her i pa suvatuar. Ajo plotësonte kërkesat më kryesore të jetesës, si përgatitja dhe marrja e ushqimit, kryerja e ndonjë punë të ekonomisë familjare qoftë e karakterit bujqësor, qoftë artizanale. Ajo përdorej për ngrohjen, qëndrimin dhe fjetjen e pjestarëve të shtëpisë, sidomos të të moshuarve dhe të vegjëlvë. Ky mjedis ishte përgjithësisht i errët, me ndriçim shumë të pakët natyror. Elementët dhe paisjet kryesore të këtij ambienti ishin, *vatra e zjarrit* ku ndizej zjarri dhe gatuhej, ajo shoqërohej edhe me *kamare* ku vendoseshin kandilat për ndriçim dhe të paisjeve të tjera të kuzhinës, *dollape* muri, këndi i larjes së enëve i paisur me një *sqollë* për derdhjen e ujërave jashtë, këndi i mbajtjes së ujit të pishëm, *sergjenët*, *magjja* ku përgatitej buka.

**Oda e miqve** është mjedisi i dytë kryesor i familjes. Asaj i është kushtuar më shumë rëndësi në elementët dekorativë. Oda e miqve është kthyer kështu në një mjedis paraqitës të shtëpisë që tregonte pozitën shoqërore të familjes.

Në kompozim oda e miqëve vendosej gjithnjë në katet më të larta të banimit. Përmasa e saj zakonisht janë tepër të mëdhaja, duke shprehur me këtë funksionin e rëndësishëm të saj, ashtu edhe prirjen e familjes fshatare për të trguar vëndin që zinte ajo në shoqëri. Funksioni kryesor i odës së miqëve ishte pritja e mikut, i cili gjatë qëndrimit shoqërohej jo vetëm nga burrat e shtëpisë por edhe nga burra të tjerë të fshatit. Vendi kryesor i ndënjës ishte rreth vatrës dhe gjithçka ishte organizuar në mënyrë të tillë që të nderohej sa më shume e të pritej sa më ngrohtë miku. Anash oxhakut janë hapur *kamare* nga të cilat dallohej *dollapi i kafesë, pranë vendit të të zotit të shtëpisë*. Dollapi i kafesë shërbente për vendosjen e enëve për bërjen e kafesë, të cilat i përdortë vet i zoti i shtëpisë. Poshtë shtjoheshin *postiqe (lëkurë deleje dhe dashi)* dhe anash vendoseshin jastiqe. Muret ishin të suvatuara dhe të lyera me gëlqere, dyshëmeja ishte e shtruar me dërrasë dhe ndriçimi ishte i bollshëm. Mjedisi zbukurohej edhe nga dekorimi i elementëve drusor. Oda e miqëve shërbente edhe si dhomë ngrënieje, ose si dhomë fjetjeje. Shërbimet dhe nevojat zakonisht kryheshin brenda këtij ambienti pa patur nevojë të dilej jashtë. Oda e miqve zakonisht ishte e paisur me nyje sanitare të veçanta pranë së cilës ishte hapur edhe një llojë lavamani, që në disa krahina quhej *avdes'hane*.

**Burgu i gjasë** ishte mjedisi i tretë i rëndësishëm i banesës, në të srehoheshin bagëtia, përgjithësisht qetë e punës, lopët, dhe kafshët e ngarkesës. Burgu i bagëtisë ishte krejt i mbyllur, dhe ajroset nga të çara në formë frëngjish.

Përveç mjedisëve të mësipërme, shpesh takohen kthina për fjetjen e kurorave të veçanta të cilat njihen me emrin **e rame, shtrat, çardak, odë** etj. Ato ndërtoheshin që në fillim brënda vëllimit të banesës, krahas mjedisëve të tjera. Dhomat e fjetjes njiheshin me emrin e burrit që e zotërontë dhe sipas zakonit, përveç çiftit askush nuk kishte të drejtë të hynte në të. Këtu

mbaheshin edhe fëmijët e gjirit, ndërsa fëmijët më të mëdhenj flinin në dhomën e zjarrit osë në odën e miqëve. Përmasa e këtyre kthinave ishin të vogla dhe paisjet të pakta. Në të vendosej shtrat i thjeshtë prej druri, djepi dhe *arka e nuses*. Rrobat vareshin në mure. Në krahinat e besimit mysliman ato shoqëroheshin me nyje sanitare dhe me këndin e larjes ose *lasen*.

Thuajse në të gjitha krahinat e këtij grupi tipologjik tipar dallues i odave të miqve ishin edhe **qoshqet** ose **qepenët** këto ishin hapësira të mbyllura që përftoheshin nga ndërprerja e mureve perimetral dhe dalja e tyre tej rrafshit të këtyre mureve. Dhoma mund të kishte një ose disa elemente të tilla. Hapësira e qosheve diferencuhej nga hapësira tjetër e dhomës: dyshemeja ngrihej në një nivel më të lartë. Shpesh paisej me tavan dërrase, muret visheshin më dërrasa të punuara dhe përmbanin dritare, të cilat jo rrallë ishin të vetme nga merret ndriçim dhoma në disa raste, kjo hapësirë veçuhej edhe nga një parmak druri. Qoshqet ishin kështu vende të këndëshme ndënjje, sidomos gjatë stinëve të ngrohta. Ato ishin vendosur në pikat më të lartë të ndërtesës. Në banesat e fortifikuara këto dalje, të mbyllura me mure guri, të paisura me frëngji dhe të vendosura në disa osë në të gjitha faqet e dhomës, e kanë humbur pjesërisht funksionin e ndënjjes. Në krahinën e Matit, këtu këto elemente gjetën përhapje më të gjerë dhe formulim më të kristalizuar, ato quheshin **çikma**.

#### 2.1.6 Analiza tipologjike

**Skema kompozicionale.** Pamvarsishtë numrit të madh të krahinave që bëjnë pjesë në këtë grup, banesa ka fituar tipare më të unifikuara. Ky unifikim shfaqet në përbërës të ndryshëm tipologjik dhe vjen si rrjedhojë e përdorimit të skemave të njëjta osë të ngjashme kompozicionale planimetrike, të trajtimit të njëjtë ose të ngjashëm arkitektonik të brendësive ose të pamjes së jashtme, e zbatimit të teknikave ndërtimore dhe e përpunimeve dekorative të njëjta ose të ngjashme etj.

Rrallëherë banesat në këto krahina ishin përdhese, përgjithësishtë ndriheshin me kate, më shpesh më dy ose me tre, duke shkuar në ndonjë rast edhe me kater, por nuk mungojnë edhe banesat me gjysëm kati.

Banesat më të thjeshta dykatëshe janë ato më një kthinë e cila përmbushte disa funksione në banësat e thjeshta. Rritja më e thjeshtë e numrit të kthinave arrihej nga ndarja e sipërfaqes së madhe të katit me një përde gardhi ose me dërrasa duke dalluar kështu dy funksione të ndryshme të kthinave.

Menyra me e përhapur e zgjerimit së banesave ishte me anë të bashkëngjitjes së dy bërthamave të thjeshta njëkthinëshe. Në këto raste, vërehej një simetri thuajse e plotë e elementëve formues ndaj murit ndarës tërthor. Banesa të tilla zakonishtë përdoreheshin nga dy familje të veçanta, (banesa vëllazërishtë), por në fazën e parë ende pa u ndarë familja, mund të përdoreheshin nga e njëjta familje. Variante të reja më të zhvilluara kemi atëhere kur banesat dykatëshe ndërtoheshin që në krye me disa mjedise me funksione të ndryshme. Rritja e

banesës me drejtim tërthorë, shpesh ka çuar më kompozime vëllimore me gjysëmkat. Por zhvillimi i banësave bëhëj edhe në drejtim gjatësor, duke ndërtuar radhazi dy deri në tre mjedise me funksione të ndryshme. Në këto raste trajtimi i jashtëm i banesës mbetet i njëjtë ndërsa ai i brendshëm ndryshontë në varësi të funksionit të mjedisit.

Përveç rugëve të përmendur mësipër të zhvillimit të banesës dykatëshe, të përgjithëshme thuajse në të gjitha krahinat e grupit, ndeshemi edhe me kompozime të veçanta e me intëres, por me një shtrirje të kufizuar brenda një krahine ose një fshati.

Ndërtimi i banësave të reja nuk bëhëj vetëm për qëllime ndarjeje. Në krahinat në shqyrtim nuk përjashtohet ekzistenca e familjeve të mëdha, me shumë pjesarë, të cilat i rezistuar deri vonë shpërbërjes. Dora-dorës me rritjen e kërkesave shtohen edhe ndërtimet brenda një oborri të përbashkët duke formuar komplekse ndërtimes të një familjeje. Në këto raste organizimi i kompleksit nuk i nënështrohej zgjidhjeve të rastësishme. Çdo ndërtim ishte i paramenduar dhe me synim të veçantë. Kështu zakonishtë, këto komplekse kishin një shtëpi zjarri dhe një shtëpi për miqtë, të përbashkët si dhe nëdrime të veçanta për banimin e kurorave të familjes. E menduar ishte gjithashtu dhe vendosja e këtyre ndërtimeve në oborr, për një shfrytëzim sa më funksional të hapësirës, sipas nevojës dhe kërkesave të familjes së madhe.

Banasa e Mustafa Shehut në fshatin Zerqan të Bulqizës, ndonëse ka edhe kjo një shtëpi zjarri të madhe dallohet nga një koncept tjetër kompozicional. Kjo banesë është një banesë gjysëmkat, shtëpia e zjarrit e vendosur në pjesën e prapme është përdhese ose pjesërisht e tillë. Ajo paraprihet në një anë të saj nga një hajat i hapur. Në këtë banes mund të shohim formën më të shpëstët të zhvillimit të banësave atë të bashkimit të dy njësive kompozicionale, shtëpin e zjarrit apo të grave dhe atë të burrave. Në këtë banes mund të shohim edhe drejtimin tjetër të zhvillimit të banësave, atë vertical. Banesë është me tre kate, nga të cilat një kat është pjesërisht nëntok, duke kryer kështu diferencimin funksional të mjediseve sipas kateve. Në katin përdhe strehohen bagëtitë, në katin e dytë është dhoma e burrave, në njërin bërthamë dhe shtëpia e zjarrit në bërthamën tjetër, ndërsa në të tretin është oda e miqve. Lidha e kateve në këtë banes bëhet me shkallë të jashtëme. Por zhvillimi i banesës nuk përfundon me arritjen te banesa tri katëshe. Mbasi u siguruan këto ndërtime mjediset më të nevojshme të familjes, kërkesat që shtroheshin, si pasojë e rritjes së mëtejshme të familjes, u plotësuan në mënyra të ndryshme. Shtimi i kthinave brenda vëllimit të ndërtesës më anë të veçimit të tyre më ndarje të lehta nga hapësira e mjediseve kryesore ekzistuese. Por ky shtim kishte një kufi, aq sa mund të mbante hapësira e mjedisit, pa dëmtuar funksionin kryesor. Përtej këtij kufiri u kalua në nxjerrjen jashtë nga banesa e mjediseve të tjera.

#### **2.1.7 Trajtimi arkitektonik i banesës**

**Banesat me çardak, banesat me qoshk, banesat me teliz, kullat dhe banesat e fortifikuara.**

(Më poshtë do flasim vetëm për banësat më çardak dhe me qoshk si element përbërës të banesës së Mustafa Shëhut)

Në qoftë se skema kompozicionale dhe zhvillimi i tyre, përveç zgjidhjeve të veçanta që u vunë në dukje, janë pak a shumë të njëjta për të gjitha krahinat e marra në shqyrtim, ato fitojnë tipare të veçanta të trajtimit të jashtëm arkitektonik që i dalojnë banesat ndërmjet krahinave. Shpesh elementët karakteristk të trajtimit arkitektonik bëhen shkak për emertimin e banesave në popull. Kështu dëgjohet të thuhet shtëpia me çardak, me qoshk, me telize, kulle, etj.

**Banesat me çardak** e kanë marrë emrin nga tremet e hapura në të dyja katet, si njësi të rëndësishme kompozicionale. Këto banesa ishin karakteristike në viset e ulëta të Shqipërisë së Mesme, por ato gjetën një përdorim, ndonëse të kufizuar, edhe në disa fshatra të Dibrës, sin ë Zerqan, në Herbel etj. Njësi të tilla u ngjiten deri në disa fshatra malore, si; në Shkretë të Malësisë së Krujës, . Për këto rastë, për ti rezistuar klimës së ftohtë, i gjejmë të mbyllura më një përdë dërrase.

Një përhapje shume më të gjerë pati **banesa me qoshk**. Qoshku është një element i rëndësishëm dhe karakterizues në kompleksin e interiorit të odës së miqve. Po këtë rëndësi ai e fiton edhe në formulimin e jashtëm arkitektonik. Atë e gjejmë në të gjitha variantet dhe skemat kompozicionale në një sërë krahinash: në Dibër, Mat, Krujë, Tiranë etj. Ato vendosen në pikat më të larta të banesës, prej nga zakonisht hapet një pamje e gjerë e perjsazhit rrethues. Dapja e tyre përpara, mbahet nga zgjatimi i trarëve ose nga pajanta. Ato shoqërohen herë –herë me ballkone të hapura dhe të përfshira nga streha e gjerë e çatisë. Ajo hedh një hije diku më të thellë e diku më të cekët, duke e bërë më të efektshme lëvizjen e vëllimit. Qoshqet shërbejnë si element kryesorë në gjallërimin e trajtimit arkitektonik.

#### 2.1.8 Teknika e ndërtimit

Teknika e ndërtimit është një faktor tjetër uniteti ndërmjet krahinave të Masivit Qendrorë të Shqipërisë Veriore. Kjo ka ardhur si pasojë e veprimit të grupeve ose atelieve të njehta mjeshtërisht ndërtimi. Mjeshtrit e ndërtimit kanë shfrytëzuar materialet rrethore të çdo krahine dhe u janë përshtatur kërkesave të reja.

**Muratura.** Teknika më e përdorur dhe më e përhapur ka qenë ndërtimi me gurë të lidhur me llaç balte dhe i përforcuar me breza druri, por nuk mungo edhe ndërtimi me qerpiç i përforcuar me breza druri (Fig.3) ose një ndërthurje midis të dyjave ( Fig.4). Ndërtimi me gurë të lidhur me llaç balte dhe i përforcuar me breza druri, lejon përdorimin e çdo lloji guri pasi qëndrueshmëria e muraturës sigurohet nga cilësia e përpunimit të qosheve të ndërtesës dhe e lidhjes së brezave të drurit. Qoshet ndërtohen me gurë më të mëdhenj e të skuadruar me kujdes, ndërsa faqet e murit me gurë të zakonshëm të punuar në një anë. Brezat e drurit vendoseshin çdo 80-100cm dhe kalonin pa ndërprerje gjatë gjithë perimetrit të ndërtesës. Zakonisht vendoseshin dy breza në të dyja faqet e murit, të lidhura ndërmjet tyre me binar

tërthorë, por kishte raste kur vendoseshin edhe tre të tillë. Për brezat zgjidhej lëndë e qëndrueshme, pishe ose lisi. Ato kapeshin me kllapa dhe mbërtheheshin më gozhda kovaçi. Brezat shërbenin për nivelimin e strukturës së murit dhe gjithashtu luanin rolin e brezave antisizmik. Pjesa e brendëshme e muraturës mbushej më gurë të pa përpunuar.

Forcimi i tipareve mbrojtëse dhe përgjithësimi i banesave të fortifikuara çoi në përhapjen e muraturës të ndërtuar me gurë të lidhur me llaç gëlqere. Banesat e ndërtuara sipas kësaj teknike përgjithësisht ishin tre katëshe. Përveç muraturës prej guri, në muret ndarës dhe në ato të ndërtimeve ndihmëse janë përdorur teknika më të thjeshta. Ato janë ndërtuar me materiale të lehta, me thupra degësh, me skelet druri të veshur në një , a në dy krahët, me gardh ose me paretka dërrase e të lyera me baltë ose suva (në ndërtimet e një fazë më të vonshme), si dhe me dërrasa të gjera dhe të afëruara me njëra-tjetrën, ku në pjesën e bashkimit të tyre vendosej nga jashtë një listël e hollë duke mbuluar kështu boshllikun midis tyre.



*Figura 3. Mur me qerpiç dhe breza druri, banesa e Mustafa Shehut, Zerqan*



*Figura 4. Ndërthurja e murit të gurit me ate të baltës, banesa e Mustafa Shehut, Zerqan*

**Suvatimi**, është përdorur rrallë në ndërtimet e këtyre krahinavë, dhe vetëm në disa mjedise, si në odën e miqve dhe në dhomat e fjetjes. Zakonishtë në të dyja llojet e muraturës si ato me baltë edhe ato me llaç gëlqere, përdorej shtresa e pare me llaç më të trashë dhe sipër saj vendosej një shtresë më e hollë.

**Daljet konsol** të elementëve të ndryshëm arkitektonik si ballkoni i katit të sipërm, qoshet, telizet e ballkoneve, realizoheshin zakonishtë me zgjatjen e trarëve të dyshemesë, në rastet kur ato ishin në një nivel më lartë, realizoheshin me daljen e trarëve të fiksuar në strukturën e murit, në rastet kur pesha ishte e madhe apo përfordheshin me 2 ose 3 trarë (Fig.5). Ndërsa në daljet e çëkmave, zakonishtë në banesat e zonave malore, struktura mbështetej mbi *ancakë* guri.



Figura 5. Daljet konsol, banesa e Mustafa Shehut, Zërqa

**Çatitë.** Format më të përdorshme të çative ishin me katër ose më shumë kullimi sipas formës së planimetrisë. Ato mbulohehin përgjithësisht në vendet e ulëta me *tjegulla të lugëta*, dhe në vendet malore me *rrasa guri* ose *furde*. Konstruksioni mbajtës i çatisë realizohej më lëndë druri, pa ndonjë përpunim të veçantë. Zakonisht në çati dhe në ndërkate vendosej lëndë e rrumbullakët druri pothuajse siç pritej në pull, duke i hequr vetëm lëvoren. Prerja e drurit bëhej në periudha të caktuara të viti dhe lihej 6 muaj deri në një 1 vit pa u përdorur, për të fituar një lloj stazhionimi natyror (Fig. 6).

**Dyshemetë** realizoheshin në varësi të mjedisit dhe të shkallës së zhvillimi të banesës. Në mjediset përthe përdorej zakonisht si shtresë truall natyror i rrafshuar dhe i përpunuar. Në shtëpinë e zjarrit të vendosur në kat, më të përgjithëshmet kanë qenë dysheme të formuara nga një shtresë balte mbi strukturën e trarëve e cila sipër lyhej her pas here me një shtresë të hollë argjile. Një shtresë e tillë kishte veti termoizoluese.

Në banesën e Mustafa Shehut, Zërqa kemi një detaj shumë interesant të dyshemes së dhomës së zjarrit. Dukeqënë se dhoma e zjarrit është në katin e parë, mbi ambientin ku mbaheshin bagëtit, dyshemeja është e përbërë nga 4 shtresa; mbi trarët e dyshëmësë vendoset një shtresë derrase rreth 4cm (në pjesën më të madhe të dyshemes aktualisht vërehet se në

vend të derrasave janë vendosur drure të një diametri jo më të madh se 7cm, të pa përpunuar dhe pa i hequr levoren) mbi të cilën vendosesh një shtresë më gjethe dushku( kjo shtresë shërbente për të mos lejuar shtresën e dheut të binte ndërmjet drurëve të pa përpunuar). Mbi gjethet e dushkur hidhej një shtresë dheu (nga sa shihet në vend dheu është i përzier edhe me gurë të vegjël me një diametër jo më të madh se 2.5cm) rreth 5 cm duke e niveluar mire e cila shërbente gjithashtu edhe si termoizolues shumë i mirë, mbi këtë shtres vendosej një shtresë horasan (llaç me pluhur tulle) rreth 1cm, e cila ishte edhe hidroizoluese (Fig.7)



*Figura 6. Struktura e çatisë, banesa e Mustafa Shehut, Zerqan*



*Figura 7. Struktura e dyshemesë së dhomës së zjarrit, banesa e Mustafa Shehut, Zerqan*



Figura 8. Struktura e dyshemesë së odës së miqve, banesa e Mustafa Shehut, Zerqan

Në odën e miqve me të përdorura kanë qënë dyshëmët e shtuara më dërrasë. Ashtu si gjith lënda drusor e përdorur në banes edhe dërrasa e dyshemese kishte përpunim të pakët. Ajo nxirrej nga sëpata, kishin gjerësi e trshësi të madhe dhe vendoseshin pranë njëra tjetrës. Më vonë, në banesat e zhvilluara, u përdoren edhe dërrasa sharre, të fiksuara me gozhdë ose të bashkuara me kllapa. (Fig. 8).

Struktura konstruktive e banesës synonte në zgjidhje përgjithësisht të thjeshtë, të bazuar në sistemin tra-kolonë. Elementët mbajtës konstruktiv si qemeri ishin të pa njohur. Megjithatë një përdorim shumë të gjerë, sidomos në banesat e ndërtuara tërësisht me gurë, gjetën mbulesat e harkuar të portave dhe dritareve. Ato ishin njëkohësisht edhe tregues i një përkujdesje të madhe dekorative. Shpesh realizimi i mbulesave të harkuara bëhej me dy radhë. Radha e parë përbëhej nga 1-3 gurë të përpunuar me kujdes, të cilët luanin rolin kryesor dekorativë, ndërsa radha e dytë merrte funksion mbajtës. Element të veçantë arkitektonik, sidomos në banesat e ndërtuara tërësisht me gurë, janë tëveshura me plastikë dekorative, me gdhendje apo relieve kryesisht në gurë. Përveç vlerave zbukuruese të tyre ato kanë një përmbajtje të caktuar simbolike, elementët më të dekoruar ishin portat hyrse dhe balli i oxhakut, të cilat simbolizonin pozitën shoqërore dhe ndërin e familjes. Motivet që zbukurojnë këto element ishin të shumëllojta: kozmike, floreale, zoomorfe etj. Nuk mungonin gjithashtu motive gjeometrike, si dhe vegla pune të mjeshtëreve. Megjithatë përgjithësisht këto gdhendje u takojnë periudhave të vona, një pjesë e motiveve ka ruajtur kuptimin magjik, duke simbolizuar mbrojtjen e banesës,

pjellorinë, bagëtinë etj., ndërsa motive të tjera lartësojnë virtyte të popullit, si besën, mikpritjen, patriotizmin etj.



Figura 9. Struktura me hark, çezma dhe porta hyrëse, banesa e Mustafa Shehut, Zerqan

### 3 PËRSHKRIMI ARKITEKTONIK DHE GJENDJA EKZISTUESE:

#### 3.1 Përshkrimi arkitektonik

Në pjesën veriore të fshatit Zerqan të bie në sy një kompleks ndërtimor i qarkuar me mure rrethuese. Kompleksi është i përbërë nga objekti i banimit dhe dy ndërtime kult, një faltore në krahun jugor të banesës dhe një tyrbe e pozicionuar në krahun perëndimor të oborrit të saj. Në anën jugore ka qenë ndërtuar faltorja dykatëshe (sot është ndërtuar një xhami 2 katëshe) dhe në vazhdim të saj po në këtë drejtim është ndërtuar korpusi kryesor trekatësh që përfaqëson shtëpinë e burrave. Përballë këtij korpusi, në anën perëndimore ndodhej tyrbeja, e cila është rindërtuar në vitet 90, mbi rrënojat ekzistuese. Në anën veriore të tyrbes ndodhet dhe porta kryesore e hyrjes për në oborr. Në pjesën veriore të kompleksit gjendet shtëpia e grave, një ndërtim ky me gjysmë kat që është më i vjetri në këtë grup banesash (Fig.10). Korpusi kryesor përbëhet nga tri banesa (bërthama) të bashkëngjitura me njëra-tjetrën. Fillimisht është ndërtuar bërthama e parë ose shtëpia e zjarrit datimi i së cilës nuk dihet. Në gjysmën e dytë të shek. XIX është ndërtuar bërthama e dytë apo shtëpia e burrave, në vazhdim të faltores. Në

katin e dytë të kësaj bërthame shtjellohet një çardak i gjerë, i hapur, i cili paraprin dhomën e pritjes me një varg dritaresh me kapakë dërrasë (Fig.11).



Figura 10. Orthofoto e kompleksit

Në katin e dytë të kësaj bërthame shtjellohet një çardak i gjerë, i hapur, i cili paraprin dhomën e pritjes me një varg dritaresh me kapakë dërrasë (Fig.11). Dhoma e pritjes merr dritë dhe nga çardaku nëpërmjet dritareve me kafazile druri. Përqark kthinës ngrihet minderi prej dërrase. Ndërtimi dykatësh (bërthama e tretë) i çerekut të dytë të shek.XX në brendësi të oborrit i është bashkangjitur bërthamës së parë të korpusit kryesor nga ana perëndimore, duke dëmtuar formulimin arkitektonik dhe anës funksionale të fillimit (Fig.12-13-14). . Banesë është tre kateshe, nga të cilat një kat është pjesërisht nëntok, duke kryer kështu diferencimin funksional të mjediseve sipas kateve.

Në katin përdhe strehohen bagëtitë, në katin e dytë është dhoma e burrave, në njërin bërthamë dhe shtëpia e zjarrit në bërthamën tjetër, ndërsa në të tretin është oda e miqve. Lidha e kateve në këtë banes bëhet me shkallë të jashtme.

Por zhvillimi i banesës nuk përfundon me arritjen të banesa tri katëshe. Mbasi u siguruan këto ndërtime mjediset më të nevojshme të familjes, kërkesat që shtroheshin, si pasojë e rritjes së mëtejshme të familjes, u plotësuan në mënyra të ndryshme. Shtimi i kthinave brenda vëllimit të ndërtesës më anë të veçimit të tyre më ndarje të lehta nga hapësira e mjediseve kryesore

ekzistuese. Por ky shtim kishtë një kufi, aq sa mund të mbante hapësira e mjedisit, pa dëmtuar funksionin kryesor. Përtej këtij kufiri u kalua në nxjerrjen jashtë nga banesa e mjediseve të tjera.



Figura 11. Bërthama e parë, fasada lindore



Figura 12. Fazat e ndërtimit të bërthamave, banesat



Figura 13. Bërthama e dytë, hajati dhe çardaku i saj, fasada perëndimore



Figura 14. Bërthama e tretë, fasada perëndimore dhe jugore

### 3.2 Ndërhyrjet ndërvitë

Që nga shpallja monument kulture i këtij objekti, në vitin 1977, janë hartuar dhe zbatuar vetëm dy projekte restaurimi nga IMK.

*Punimet restauruese të kryera në vitet 1979-1981, janë zbatuar duke patur parasysh kriteret e mëposhtëme:*

- Së pari, të rindërtoheshin pjesërisht apo plotësisht, sipas gjendjes që paraqiteshin, disa elemente përbërëse konstruktive arkitektonike, që ishin pjesërisht apo plotësisht të dëmtuara, duke u mbështetur gjithnjë në elementet origjinale.
- Së dyti, brenda mundësive, për vetë funksionin që kishte monumenti, të hiqeshin shtesat pa vlerë që kishin tjetërsuar anën funksionale dhe trajtimin arkitektonik të ndërtimeve në fjalë. Gjatë këtij restaurimi u pat si synim të evidentoheshin dhe shtresa që mund të hiqeshin në të ardhmen, kur të krijohet mundësia që kompleksi të merrte një funksion të ri.

**Në bërthamën e dytë** fillimisht punimet e restaurimit u filluan në ndërtimin trekatësh (banesën e burrave apo bërthamën e dytë) në vazhdim të faltores. Këtu u përforcuan muret perimetrale që ishin të dëmtuara (Fig. 15-16). Në katin e parë të banesës u rindërtuan pjesërisht tavanet prej dërrase, dyert, dhe u bënë suvatimet. Në katin e dytë u restauruan elementet e dëmtuar të parmakllëkut të çardakut dhe tavani i tij (Fig.17-18). Në kthinën e pritjes u rindërtuan minderet dhe dritaret. Dritaret pranë oxhakut të ndërtuara më vonë u mbyllën. U restaurua dhe çatia e kësaj bërthame (Fig.18).



Figura 15. Bërthama e dytë, fasada lindore viti 1979



Figura 16. Bërthama e dytë, fasada lindore viti 1979




Figura 17. Bërthama e dytë, fasada perëndimore viti 1979, parmakllëqet



Figura 18. Bërthama e dytë, fasada perëndimore viti 1979, çardaku



Figura 19. Bërthama e parë, fasada lindore (majtas) dhe jugore (djathtas) viti 1978

Në bërthamën e parë (Fig. 19).




Figura 20. Bërthama e parë, kati përdhe, projekti 1979

### Kati përdhe

Ambienti 1;

- Rindërtimi i murit të shëmbur së bashku me themelet me gurë dhe llaç gëlqere ndërthtur me breza druri (muri që ndan ambienti 1 dhe 3).
- Rindërtimi i murit që ndan ambientin 1 dhe 4, mur guri llaç gëlqere ndërthtur me breza druri.
- Rindërtimi i murit në fasadën jugore – lindore ((Fig.20 evidentuar me heç të kuq).
- F.V derë druri sipas konfiguracionit origjinal.

Ambienti 2;

- F.V derë druri sipas konfiguracionit origjinal, me koshek dhe gozhda kovaçi.




Figura 21. Bërthama e pare, kati i parë, projekti 1979

### **Kati i parë**

Ambienti 1;

- Rindertimi i dysheves me të njëjtën teknin si origjinali: përmbi trar vendosen një shtresë dërrase 4cm mbi të cilat shtrohet një shtresë më gjethe dushku. Mbi gjethet hidhet një shtresë dheu jo i situr rreth 5 cm, mbi këtë shres niveluesë vendoset një shtresë llustër horasan.
- Risuvatim i ambientit me llaç gëlqere.

- Ndërtimi tavanit të ri me teknikën origjinale: vendosjen e listelave prej druri (purteka të holla 1cm. Trashësitë mbërthyer tëk trarët) dhe suvatim i tij me llaç gelqereje.
- Pastrimi i dyerve me sodë kaustie dhe lyerja e tyre me vaj lini.
- F.V dritaresh sipas modelit ekzistues.
- Suvatimi i fasadës prej qerpiçi.
- Instalimet elektrike.

#### Ambienti 2;

- Rindërtimi i dyshemes me të njëjtën tëknin si origjinali: përmbi trar vendosen një shtresë dërrase 4cm mbi të cilat shtrohet një shtrësë më gjethe dushku. Mbi gjethet hidhet një shtresë dheu jo i situar rreth 5 cm, mbi këtë shres niveluesë vendoset një shtresë llustër horasan.
- Muri lindor nga ana e brendëshme (qoshku), është zhveshur nga suvaja, elementët prej druri janë çmontuar dhe pastuar me sodë kaustike si dhe lyer me vaj lini dhe janë ri montuar.
- Kanatat e dritareve dhe fashaturat e qoshkut janë zvendësuar sipas konfiguracionit origjinal.
- Suvatim i qoshkut brenda dhe jashtë.
- Rindërtimi dhe suvatimi i murit që e ndan me ambientin 2 si dhe fasada jugore (dalja në oborrin e brendëshëm) duke lënë në dukje kollonat prej druri, jastikun dhe traun lidhës (Fig. 22).
- Ndërtimi tavanit të ri me teknikën origjinale: vendosjen e listelave prej druri (purteka të holla 1cm. Trashësitë mbërthyer tëk trarët) dhe suvatim i tij me llaç gelqereje.
- suvatimi i gjith ambientit me llaç gëlqere
- F.V. derë me konfiguracionin origjinal.
- Intalimet elektrike

#### Ambienti 3;

- Suvatim i ambientit me llaç gëlqere.
- Tavan i ri i suvatuar (me purteka të holla dhe suva).
- Instalime elektrike.

#### Ambienti 4;

- Suvatim i ambientit me llaç gëlqere.

Figura 22. Fasada jugore, oborri i brendëshëm, viti 2019



- Rindërtimi dhe suvatimi i murit që e ndan me shkallët dhe ndërtimi i një dritareje (Fig.21). Aktualisht këto shkallë nuk janë më.
- F.V. derë me dërrasa të afuara dhe dy kushakë (mentesha).
- Tavan i ri i suvatuar (me purteka te holla dhe suva).
- Instalime elektrike.

#### Ambienti sanitar 5;

- Muret perimetral, janë rindërtuar prej qerpiçi ndërsa ata ndarës me çatma.
- Suvatim i brendëshëm dhe nga jashtë me llaç gëlqere.
- Rindërtimi i dyshejes me të njëjtën tëknin si origjinali: përmbi trar vendosen një shtresë dërrase 4cm mbi të cilat shtrohet një shtresë më gjethe dushku. Mbi gjethet hidhet një shtresë dheu jo i situr rreth 5 cm, mbi këtë shres niveluesë vendoset një shtresë llustër horasan me pak çimento.
- F.V. derë me dërrasa të afuara dhe dy kushakë (mentesha).
- F.V e dy EC allaturka prej graniti dhe tubacionet e drenazhit me tuba gres.
- Instalime elektrike.

#### Shkallët 6;

- Restaurim shkallësh vetëm në pjesët e dëmtuara.

#### Ambienti 7;

- F.V. i parkamut sipas konfiguracionit ekzistues (Fig. 19)
- Suvatim i ri me llaç gëlqere.
- Suvatim i tavanit.
- Restaurim shkallësh guri, jashtë (Fig.19).
- Instalimet elektrike.

#### Koridori 8;

- Suvatim i murit me llaç gëlqere.
- Ndërtim tavani dhe suvatim me llaç gëlqere.
- Instalime elektrike.

#### Ambienti 9;

- Suvatim i murit me llaç gëlqere.
- Ndërtim tavani dhe suvatim me llaç gëlqere.
- F.V dritare

- Rindertimi i dyschemes me të njëjtën teknin si origjinali (si në ambjentet e tjera).
- Instalime elektrike.

#### Ambienti 10;

- Rindertimi i dyschemes me të njëjtën teknin si origjinali: përmbi trar vendosen një shtresë dërrase 4cm mbi të cilat shtrohet një shtrësë më gjethe dushku. Mbi gjethet hidhet një shtresë dheu jo i situr rreth 5 cm, mbi këtë shres niveluesë vendoset një shtresë llustër horasan me pak çimento.
- Suvatim i murit me llaç gëlqere.
- Ndërtim tavani dhe suvatim me llaç gëlqere.
- F.V dritaresh sipas modelit ekzistues (gjatë këtij procesi mendojme se janë zgjeruar dritaret, nga jashtë, nga 52 cm jashtë-80cm brenda në 120cm).
- Instalime elektrike.

#### Ambienti 11;

- Suvatim i murit me llaç gëlqere.
- Rindertimi i dyschemes me të njëjtën teknin si origjinali (si në ambjentet e tjera).
- F.V tavan fibër.
- Hapje dere në fasadën veriore.
- Restaurim i fashaturave të dollapeve.
- Instalime elektrike.

**Në bërthamën e tretë** të korpusit kryesor, në krahasim me ato dy të parat, ndërhyrjet ishin relativisht më të mëdha, por natyra e tyre ishte thuajse e njëjlojtë (Fig.20).



Figura 23. Bërthama e tretë, fasada perëndimore (majtas) dhe jugore (djathtas) viti 1978

Në shtëpinë e grave (berthama e pare) u sigurua fillimisht gjendja statike e mureve perimetrale, për këtë qëllim një pjesë e tyre u rindërtuan pjesërisht dhe disa si ai i pamjes kryesore, u përforcua me një mur mbajtës. Në katin e parë të shtëpisë së grave gjatë kohës dhe pikërisht në vitet 30-40 të këtij shekulli ishin bërë disa punime, të cilat kanë dëmtuar rëndë anën funksionale dhe trajtimin arkitektonik të pamjes jugore duke qenë kjo fillimisht e hapur, për të cilën tregonin qartë kolonat dhe qostekët e gdhendur. U restaurua çatia me strehë dyfishe e bazuar në elementët e pakta origjinale.

Ndërhyrjet restauruese bënë që monumentit t'i sigurohej në shkallë relativisht të madhe qëndrueshmëria statike. Monumenti rifitoi në po këtë shkallë vlerat e humbura estetike dhe arkitektonike që kishte pasur ai fillimisht. Gjithashtu u përmirësuan kushtet e banimit nëpërmjet ndërtimit të disa elementëve siç ishin ndarjet me fibër (Fig.22), të cilat ishin plotësisht të heqshme me të marrë monumenti funksionin e ri të mundshëm etnografik apo historik i zonës, duke qenë se Zerqani është qendër e lokalitetit të përbërë nga 13 fshatra rreth tij. Gjatë punimet restauruese të këtyre viteve janë ndërtuar edhe shkallët prej druri që realizojnë ngjitjen nga oborri në çardak, si dhe ndarja me parmak druri e çardakut. Në krahun lindor të portës dytësore hyrsë për në oborr është ndërtuar edhe një nyjë sanitare (Fig. 21).




Figura 24. Plani dhe prerjet e tualetit në murin rrethues (në rahë të portës) si dhe shkallët dhe ndarja e çardakut




Figura 25. Bërthama 2-Plani i katit të dytë, punimet e kryera gjat restaurimeve në vitin 1979-1981



Figura 26. Ndarjet e reja të realizuara gjatë punimeve restauruese të viti 1979-1981 (Shtëpia e burrave-foto 2019)

Pas viteve 1990, pronarët e banesës kanë restauruar tyrbën, pjesë përbërëse e banesës, në qoshen jug-perëndimore të oborrit të jashtëm, sipas një projekti të hartuar nga specialist të IMK-së (Fig. 24). Nga dokumentacioni fotografik prane arkives së IMK-së mund të vërehet qartë së muri perëndimor dhe jugor i tyrbës ka shërbyer si pjesë përbërëse e murit rrethues të oborrit të jashtëm të kompleksit të banesës. Nga foto mund të shikojmë qartë gjithashtu se në qendër të të dyja pareteve të mbetura nga tyrbja janë dritaret e tamponuara me murë guri (Fig.25).

Aktualishtë tyrbja është funksionale dhe vizitohet nga besimtarë të zonës. Brenda saj janë të vëndosura dhe 4 varre me çallmat origjinale, të Shehllervë të brezave të ndryshëm të familjes Shehu. Emrat e të cilve familjarët e tanishëm të banesës i kanë paraqitur në Pemën Gjeneologjike të familjes që fillon që nga viti 1600 (Fig.26). Krahun jugor dhe perëndimor i tyrbës, nga ana e jashtme rrethohet me një varrezë të ngritur nga niveli i rrugës rreth 60cm me një mir guri ciklopik. Në foton e vitit 1979 mund të dallohet edhe varreza që rrethon tyrbën.

Vitet e fundit familjarët dhe banorët e fshatit kanë ringritur një xhami 2 katëshe, mbi themelet e faltores së vjetër.




Figura 27. Pjesë e projektit të tyrbës hartuar nga IMK




Figura 28. Muri perëndimor (në të majtë) dhe ai jugor (në të djathtë) i tyrbes, foto e vitit 1979




Figura 29. Pema Gjeneologjike e familjes Shehu




Figura 30. Çallmat origjinale të Shehllerëve

Puminet restauruese të kryera në vitet 2007 janë realizuar vetëm në shtëpin e burrave (bërthama e dytë) dhe kanë konsistuar në:

**Kati i parë:**

- Hajati (shtëpia e burrave ose bërthama e dytë).  
Restaurimi i shtyllave dhe jastikëve prej druri sipas teknikës origjinale.  
Restaurimi i dy shkallëve prej druri si dhe parmakëve sipas konfiguracionit dhe teknikes origjinale.  
Restaurimi i suvasë në vendët e dëmtuara sipas tëknikës origjinale.
- **Mjedisi 2**  
Suvatim i plot i mjedisit.  
Restaurim tavani dërrase sipas teknikës origjinale.  
Larje e dyerve më sodë kaustike dhe restaurimi i dritareve.
- **Mjedisi 4 dhe 5**  
Restaurimi i suvasë.  
Restaurim i dyshemesë prej druri në vendet e dëmtuara.  
Fiksim, pastrim dhe nivelim tavani prej druri.  
Restaurim i veshjes me dërrasë të nyjeve sanitare.  
Restaurimii dritareve dhe dyerve.
- **Hajati (shtëpia e burrave , nga oborri i brëndëshëm)**  
Restaurimi i plotë i shtyllave dhe jastikëve prej druri sipas teknikës origjinale.  
Restaurimi i muraturës së gurit dhe suvatimi plotë i mjedisit.  
Restaurimi i plotë i shkallës dhe parmakëve prej druri sipas konfiguracionit dhe teknikës origjinale.




Figura 31. Projekti 2007

### **Kati i dytë**

- **Çardaku (shtëpia e burrave ose bërthama e dytë)**  
Restaurimi i dyshemesë dhe tavanit prej druri sipas teknikës origjinale.  
Restaurimi i shtyllave, jastëkëve dhe parmakëve prej druri duke zvendësuar ato të dëmtuarat.  
Restaurimi i kafazlijeve të drurit.  
Restaurimi i suvasë së faqeve të çardakut.  
Lyerja me vaj lini i gjithë materialit drusor.
- **Mjedisi 2**  
Nivelim, pastrim, fiksion tavan druri.  
Restaurim dritare dhe fashaturash sipas teknikës origjinale.  
Suvatime të jashtëme në vendet e dëmtuara.
- **Mjedisi 3**  
Nivelim, fiksion tavan druri. Lyrje me vaj lini.  
Restaurim i dritareve të divanhanes dhe fashaturave.  
Suvatim i jashtëm në vendet e dëmtuara.
- **Mjedisi 4 dhe 5**  
Restaurim suva jashtë dhe brenda.  
Restaurim i veshjes me dërrasë të nyjeve sanitre dhe lyrje me vjal lini.  
Restaurim i dyshemesë dhe tavanit të dërrasës sipas teknikës origjinale duke zvendësuar pjesët e dëmtuara.
- **Çardaku (shtëpia e burrave , nga oborri i brendëshëm)**  
Restaurim mur guri sipas projektit.  
Restaurim i plotë i suvasë së çardakut.  
Restaurim i plotë i dyshemesë dhe tavanit prej druri.  
Restaurim i plotë i shtyllave, jastikëve dhe parmakëve prej druri sipas teknikës origjinale duke ruajtur pjesët e shëndosha.  
Restaurim i plotë i shkallës dhe parkakëve.
- **Fasadat**  
Sivatim fasade, restaurim i veshjeve prej druri, fugatim murature, restaurimin e fashaturave dhe dritareve duke respektuar teknikat origjinale.
- **Çatia**  
Restaurim-revizionim i çatisë duke përdorur tjegulla vendi dhe duke zvendësuar vetëm elementët e degraduar dhe jashtë funksionit.




Figura 32. Projekti 2007

### 3.3 Gjendja ekzistuese dhe ndërhyrjet e propozuara

Kompleksi i vëllezërve Shehu në gjendjen e sotme, paraqitet pjesërishtë i dëmtuar në të tre bërthamat e tij, si pasojë e mos mirmbajtjes apo edhe prej braktisjes nga banorët.

Veçanërishtë i dëmtuar paraqitet pjesa e shtëpis së burrave me dalje në oborrin e brendshëm, pronë e Kujtim Shehut, ku është dëmtuar çatia, konstruksioni i mureve, suvat e ambjenteve si jashtë edhe brenda, dyshemet dhe tavani si dhe çardaku me elementët e vet arkitektonik. Aktualishtë është e pamundur që të hyhet në katin e dytë në këtë pjesë dukeqënë së struktura e dyshemes së çardakut është e pa qendrueshme.

#### KATI PËDHE (BËRTHAMA 2)




Figura 33. Kati përdhe, bërthama 2

Ambienti 1 dhe 3;

Këto dy ambjente aktualisht janë përdorur si depo drushë nga banorët.

- Muratura është prej guri  
- ka nevojë për fugatim me llaç gëlqereje;
- Struktura e tavanit, trarët dhe pjesa e shtresës prej drurësh të pa përpunuar duken në gjendje të mirë ;
- Dyert prej druri janë të amortizuara  
– propozohet heqja e tyre dhe zvendësim me dyer të reja me të njëjtin konfiguracion dhe dru të stazhionuar.

Ambienti 2;

Ky ambjent përdoret nga pronarët si depo drushë. Pronarët kanë tamponuar me mur guri portën lidhëse midis këtij ambjenti dhe atit nr. 1 dhe kanë hapur një portë në fasadën lindore prej nga edhe hyhet aktualisht.

- Në drejtim me portën e hapur, në tavan, në murin përball portës, është hapur edhe një baxhë, që lidh ambjentet e katit të parë me këtë ambjent.  
- propozohet ndërtimi i shkallëve satike pa parrmak prej druri, për të bërë më të thjeshtë lëvizjen.



Figura 34. Kati përdhe, bërthama 2- shkallët ekzistuese posht baxhës

- Një ndërhyrje e gabuar e bërë nga pronarët është edhe shtrimi i dyshemesë së katit të parë me llaç çimento mbi strukturën ekzistuese. Pësia e shtuar ka bërë që trarët mbajtës në këtë ambient të humbin funksionin e tyre. Në veçanti njëri prej tyre ka arritur të çëdoj deri në 30-40 cm duke rrezikuar seriozisht shëmbjen e dyshemesë. Pronarët kanë marrë masa paraprake duke vendosur puntela druri poshtë secilit tra (Fig. 31).  
 - Propozohet, të bëhet puntelimi i strukturës ku janë muret ndarës të ambienteve të katit të parë (ambienti 6 dhe 7), pasi të jetë kryer puntelimi të priset shtresa e llaç çimentos, dhe të bëhet çmontimi i dyshemesë (shtresa e horasanit, e dheut, e gjetheve dhe e drurëve poshtë tyre). Të hiqen trarët e dëmtuar dhe të zvendësohen me trarë të rinj lisi të stazhionuar. Pasi të jetë kryer vendosja e trarëve të rivëndosën shtresat e dyshemes sipas metodës origjinale. Mbi shtresën e horasanti të vendoset dysheme me dhoga druri të stazhionuara dhe trajtuar me antimol dhe vaj lini, me teknikën e ndërthurjes (duke qënë se nuk ka konstrukcion ku të gozhdohen dërrasat e dyshemes propozohet vendosja e dërrasave me ndërthurje femër mashkull).
- Pasi të jetë hequr puntela të sistëmohej terreni dhe të rishikohet sistemi i drenazhimit të tualetit i cili kalon poshtë dyshemes së këtij ambienti.



Figura 35. Kati përdhe, ambienti 2



Figura 35. Kati përdhe, ambienti 2

**KATI I PARË (BËRTHAMA 2)**




Figura 36. Bërthama 2, kati përdhe

Ambienti 1 (Fig . 32);

- Ambienti 1 ose hajati i banesës është i shtruar me një shtresë llustër çimento.
  - Do të realizohet heqja e kësaj shtrese dhe shtrimi me pllaka guri të skuadruara
- Nga sa mund të shikohet në vend struktura drusore e këtij ambienti, kolonat, shkallët e drurit dhe trarët e tavanti janë në gjendje relativisht të mire.
  - Do të realizohet trajtim profesional me anti-insekticid dhe vaj lini i kësaj strukture.
- Suvaja e këtij ambienti duket në gjendje të mire.
  - Do të realizohet meremetimi i suvasë ku është e nevojshme me llaç gëlqere dhe sherbetosje me sherbet gëlqere.



Figura 37. Bërthama 2, ambienti 1 (hajati dhe çadraku)

Ambienti 2 dhe 3 (Fig. 33);

Ky ambient aktualisht është i banuar nga një banor i familjes Shehu. Përgjithësisht është në gjendje të mirë konstruktive

- Ambienti është shtruar me një shtresë llustër çimento, pësha e të cilit rrezikon shëmbjen e dyshemesë.
  - Do të realizohet heqja e kësaj shtrese dhe mbi shtresën e horasanit të vendoset dysheme me dhoga druri të stazhionuara dhe trajtuar me antimol dhe vaj lini, me teknikën e

ndërthurjs (duke qënë se nuk ka konstruksion ku të gozhdohen dërrasat e dyshemes propozohet vendosja e dërrasave me ndërthurje femër mashkull).

- Dritaret e këti ambienti janë zvendësuar me dritare duralumini.
  - Do të realizohet heqja e këtyre dritareve dhe zvendësimi i tyre me dritare druri të stazhionuar dhe trajtuar me anti mole dhe vaj lini, sipas konfiguracionit original ( Fig.15).
- Suvatimet e brendëshme përgjithësisht janë në gjendje të mirë.
  - Do të realizohet meremetimi i suvasë ku është e nevojëshme me llaç gëlqere dhe sherbetosje me sherbet gëlqere.
- Të gjitha strukturat prej druri, tavani, dyert, sergjenët me kapak druri si dhe zbukurimet murale kanë nevojë për restaurim
  - Do të realizohet pastrimi i tyre nga boja e vajit, trajtim me anti insekticid si dhe vaj lini.
- Propozohet të bëhet pastrimi i oxhakëve në të dy ambientet.
- Dera e jashtme e këtyre ambjenteve ka nevojë për restaurim
  - Do të realizohet pastrimi i tyre, lyerje me anti mole dhe vaj lini.



Figura 38. Bërthama 2, fasada lindore (e pjesshme ku evidentohen dritaret duralumin në katin përdhe)

Ambienti 4;

Ky ambient përgjithësisht është në gjendje të mirë konstruktive, aktualisht është i banuar nga banor të familjes Shehu.

- Ambienti është shtruar me një shtresë llustër çimento, si gjithë ambjentet e banesës në katin përdhe.
  - Do të realizohet heqja e shtresës së llustër çimentos dhe shtrimi me dysheme me dhoga druri të stazhionuara dhe trajtuar me antimol dhe vaj lini, me teknikën e ndërthurjs (duke qënë se nuk ka konstruksion ku të gozhdohen dërrasat e dyshemes propozohet vendosja e dërrasave me ndërthurje femër mashkull).
- Dritarja e këti ambienti është zgjeruar (mund të shikohet nga krahasimi i rlevimeve të vitit 1979 dhe gjendjes ekzistuese), ajo është më kostruksjon druri.
  - Do të realizohet restaurimi i saj, lysterje me anti mole dhe vaj lini.
- Suvatimet e brendëshme përgjithësisht janë në gjendje të mire por gjatë restaurimi të viti 2007 në nivelin e tavanit është realizuar me llaç çimento dhe rërë të ashper, e evidentueshme kjo edhe me sy të lirë.
  - Do të realizohet heqja e ndërhyrjes së viti 2007 dhe të ri suvatohet me llaç gëlqere. Ambienti duhet të lyhet me sherbet gëlqereje.
- Gjat punimeve restauruese të viti 2007 është vendosur tavan i ri druri i cili në qendër të ambientit ka pësuar shpëputje dhe rënie pjesore të të elementëve (listelave) drusor të cilat banori i ka fiksuar me ngjitës skoç transparet.
  - Do të realizohet restaurimi i tij.
- Dera është relativisht e re e lyster me boj të bardhe.
  - Do të realizohet restaurimi i saj, pastrimi nga boja e vajit, lysterje me anti mole dhe vaj lini.

Ambienti 5;

Ky ambient është një koridor prej nga mund të kalohet në tre ambjentet e tjera, 4-5 dhe 6.

- Ambienti është shtruar me një shtresë llustër çimento, si gjithë ambjentet e banesës në katin përdhe, pësja e të cilit rrezikon shëmbjen e dyshemesë.
  - Do të realizohet heqja e shtresës së llustër çimentos dhe shtrimi me dysheme me dhoga druri të stazhionuara dhe trajtuar me antimol dhe vaj lini, me teknikën e ndërthurjs (duke qënë se nuk ka konstruksion ku të gozhdohen dërrasat e dyshemes propozohet vendosja e dërrasave me ndërthurje femër mashkull).
- Suvatimet e brendëshme përgjithësisht janë në gjendje të mire.
  - Do të realizohet meremetimi i suvasë ku është e nevojëshme me llaç gëlqere dhe sherbetosje me sherbet gëlqere.
- Dera është relativisht e re e lyster me boj të bardhe.
  - Do të realizohet restaurimi i saj, pastrimi nga boja e vajit, lysterje me anti mole dhe vaj lini.
- Tavani ka nevojë për restaurim.
  - Do të realizohet pastrim, lysterje me anti mole dhe vaj lini.

- Revizionimi i instalimeve elektrike.

Ambienti 6 (Fig. 34);

- Ambienti është shtrual me një shtresë llustër çimento, pësja e të cilit ka shkaktuar çedimin e dyshemesë duke rrezikuar shëmbjen e saj.
  - Do të realizohet heqja e shtresës së llustër çimentos dhe shtrimi me dysheme me dhoga druri të stazhionuara dhe trajtuar me antimol dhe vaj lini, me teknikën e ndërthurjs (duke qënë se nuk ka konstruksion ku të gozhdohen dërrasat e dyshemes propozohet vendosja e dërrasave me ndërthurje femër mashkull).
- Dritaret dhe pjesa e dollapeve posht tyre në këtë ambienti janë prej druri të lyerja me boj të bardhe.
  - Për dritaret, arkitrarët, parmakët edhe dollapët prej druri do te kryhen punime restauruese, do të realizohet pastrimii tyre nga boja e bardhe dhe lyerjen me anti mole dhe vaj lini.
- Suvatimet e brendëshme përgjithësishtë janë në gjendje të mire.
  - Do të realizohetmeremetimi i suvasë ku është e nevojëshme me llaç gëlqere dhe sherbetosje me sherbet gëlqere.
- Tavani duket në gjendje të mirë.
  - Do të restaurohet dhe lyhet me anti mole dhe vaj lini.
- Dera ka nevojë për restaurim do ti bëhet pastrim, lyerje me anti mole dhe vaj lini.
  - Revizionimi i instalimeve elektrike.

Ambienti 7 (Fig. 35);

- Ambienti është shtrual me një shtresë llustër çimento, pësja e të cilit ka shkaktuar çedimin e dyshemesë duke rrezikuar shëmbjen e saj.
  - Do të realizohet heqja e shtresës së llustër çimentos dhe shtrimi me dysheme me dhoga druri të stazhionuara dhe trajtuar me antimol dhe vaj lini, me teknikën e ndërthurjs (duke qënë se nuk ka konstruksion ku të gozhdohen dërrasat e dyshemes propozohet vendosja e dërrasave me ndërthurje femër mashkull).
- Dritaret dhe pjesa e dollapeve poshtë tyre në këtë ambienti janë prej druri të lyerja me boj të bardhe.
  - Për dritaret, arkitrarët, parmakët edhe dollapët prej druri do te kryhen punime restauruese, do të realizohet pastrimii tyre nga boja e bardhe dhe lyerjen me anti mole dhe vaj lini.
- Suvatimet e brendëshme përgjithësishtë janë në gjendje të mire.
  - Do të bëhet meremetimi i suvasë ku është e nevojëshme me llaç gëlqere, sidomos afër dritareve, dhe lyerje me sherbet gëlqereje.
- Tavani duket në gjendje të mirë.

- Do të bëhet njëpastrim dhe lyerje me anti mole dhe vaj lini.
- Dera ka nevojë për restaurim.
  - Do të bëhet pastrim, lyerje me anti mole dhe vaj lini.
- Të gjitha strukturat prej druri si sergjenët dhe zbukurimet murale do të resaturohen, do të trajtohen me anti insekticid si dhe vaj lini.
  - Revizionimi i instalimeve elektrike.



Figura 39. Bërthama 2, ambienti 6



Figura 40. Bërthama 2, ambienti 7

Ambienti 8 (Fig. 36);

Ky ambient aktualisht nuk është i banuar, dhe është kthyer në depo mbetjesh dhe inertesh. Oxhaku i këtij ambjenti është mbyllur.

- Ambienti është shtruar me një shtresë llustër çimento, pësja e të cilit mund të shkaktoj çedimin e dyshemesë duke rrezikuar shëmbjen e saj.
  - Do të bëhet heqja e shtresës së llustër çimentos dhe shtrimi me dysheme me dhoga druri të stazhionuara dhe trajtuar me antimol dhe vaj lini, me teknikën e ndërthurjs (duke qënë se nuk ka konstruksion ku të gozhdohen dërrasat e dyshemes propozohet vendosja e dërrasave me ndërthurje femër mashkull).
- Dritaret në këtë ambienti janë prej druri të cilat kanë nevojë për restaurim.
  - Do të bëhet pastrim/plotësim i tyre dhe i arktirarëve si dhe parvazeve dhe lyerjen me anti mole dhe vaj lini. N.q.s do jetë e nevojëshme mund të bëhet edhe zvendësimi i tyre me dritare druri të stazhionuar me të njëjtin konfiguracion.
- Suvatimet e brendëshme janë në gjendje jo shumë të mire.
  - Pasi të pastrohen muret nga suvaja ekzistuesedo të bëhet suvatim i ambjentit me llaç-qull gërqereje të stazhionuar mbi 10 vjet, lesh dhie dhe të bardhe veze.
- Tavani i këtij ambjenti është me listela druri, i suvatuar me llaç gëlqere, i restauruar në vitin 1979-81, nuk duket në gjendje të keqe.
  - Do të bëhet lyerje me sherbet gëlqereje.
- Dyert janë relativisht të reja por kanë nevojë për resaturim.
  - Do të bëhet pastrimi i tyre, lyerje me anti mole dhe vaj lini.
  - Realizimi i instalimeve elektrike.



Figura 41.kati i parë, bërthama 2, ambienti 8

Ambienti 8/1 (Fig. 37);

Ky ambient aktualisht nuk është funksional.

- Struktura e këtij ambienti është e degraduar
  - Struktura prej druri e këtij ambienti ka nevoj për restaurim të mbulesës si dhe veshjes më dhoga druri të stazhionuara dhe trajtuara me antimolë dhe vaj lini. Duhet të rishikohet mundësia që ky ambjent të vihet në funksion.
  - Realizimi i instalimeve elektrike.




Figura 42. Kati i parë, bërthama 2, ambienti 8/1

Ambienti 9 (Fig. 38);

Ky ambjent aktualisht nuk është i banuar.

- Ambienti është shtruar me një shtresë llustër çimento, pësja e të cilit mund të shkaktoj çedimin e dyshemesë duke rrezikuar shëmbjen e saj.

- Do të bëhet heqja e shtresës së llustër çimentos dhe shtrimi me dysheme me dhoga druri të stazhionuara dhe trajtuar me antimol dhe vaj lini, me teknikën e ndërthurjs (duke qënë se nuk ka konstruksion ku të gozhdohen dërrasat e dyshemes propozohet vendosja e dërrasave me ndërthurje femër mashkull).
- Dritaret në këtë ambienti janë prej druri të cilat kanë nevojë për tu zvendësuar duke qënë se aktualishtë ka mbetur vetëm kasa e tyre prej druri.
  - Do të bëhet F.V dritare me dru të stazhionuar dhe konfiguracion si origjinali.
- Suvatimet e brendëshme janë në gjendje të keqe.
  - Pasi të pastrohen muret nga suvaja ekzistuese do të bëhet suvatim i ambjentit me llaç-qull gërqereje të stazhionuar mbi 10 vjet, lesh dhe të bardhe veze.
- Tavani i këtij ambienti është me fibra, i cila nuk duket në gjentje të keqe por që nuk është karakteristike për banesën.
  - Do të bëhet heqja e tavanit prej fibre dhe ribëria e tij me strukturën druri.
- Dera nuk është origjinale, është në gjendje të keqe dhe ka nevoj për ta ndryshuar.
  - Do të bëhet restaurimi i saj dhe trajtimi me antimole dhe vaj lini.
  - Struktura prej druri e dollapit të murit do të restaurohet dhe trajtohet me antimole dhe vaj lini.
  - Realizimi i instalimeve elektrike.



Figura 43.Kati i parë, bërthama 2, ambienti 9

Ambienti 10 (Fig. 39);

Hajati aktualisht është në gjendje të keqe konstruktive.

- Duke qenë se struktura e drurit të tij është nën efektin shkatërrues të agjentëve atmosferik ka bërë që kjo struktur drusore ta humbas totalisht funksionin mbajtës duke u bërë i pa qëndrueshëm. Pronarët janë munduar të përforcojnë strukturën mbantëse me puntela druri por me kalimin e kohës struktura e tavanit, trarët janë kalbur dhe janë në rrezik shëmbje. Si kolonat ekzistuese ashtu edhe puntelat prej druri nuk mbështeten mbi jastik guri, kjo i bën ato të mos jenë të qëndrueshme.
  - Do të bëhet çmontimi i kësaj strukture, dhe ri bërja e saj duke përdorur të gjitha elementët origjinal në gjendje të mirë dhe duke zvendësuar ato që janë jashtë funksionit me dru lisi të stazhionuar dhe trajtuar me anti mole dhe vaj lini.
- Struktura e shkallëve që të çon nga ky ambient në çadak, nuk duket të jetë në gjendje të keqe.
  - Do të bëhet rindërtimi i parmakut prej druri dhe trajtimi i gjith strukturës me vaj lini dhe anti molë (Fig. 40).
- Suvaja e mureve në këtë amient është në gjendje të keqe dhe ka nevojë të ribëhët.
  - Pasi të pastrohen muret nga suvaja ekzistuese do të bëhet suvatim i ambjentit me llaç-qull gërqereje të stazhionuar mbi 10 vjet, lesh dhie dhe të bardhe veze.
- Dyshemeja e hajatit është e shtruar me dhe.
  - Do të bëhet pastrimi, nivelimi dhe shtrimi me një shtresë pllakash guri.
- Në krahun perëndimor të hajatit muri mbajtës prej guri, ka çeduar dhe ka rënie gurësh.
  - Do të bëhet çmontimi dhe ri montimi i këtij muri dhe vendosja e jastikëve prej guri për mbështetjen e kolonave të hajatit.
  - Revizioniimi i instalimeve elektrike.

Ambienti 11 (Fig. 40);

Ky ambient ka funksionin e një nyje sanitare.

- Ambient është me mur çatmaje.
  - Muri prej çatmaje i këtij ambjenti ka nevojë për resaturim, do të bëhet suvatimi me llaç gëlqere dhe bojatisje me sherbet gëlqere si brenda dhe jashtë.
- Aktualisht ky ambient nuk është funksional.
  - Do të shikohet mundësia e rikthimit të tij në funksion. Realizimin e një drenazhi të ri të ujërave të zeza dhe furmizimin me uji.
- Dera është në gjendje jo të mirë.
  - Do të bëhet pastrimi i derës, dhe të trajtohet me anti molë dhe vaj lini.
  - Realizimi i instalimeve elektrike.



Figura 44.Kati i parë, bërthama 2, ambienti 10 (hajati)



Figura 45. Kati i parë, bërthama 2, ambienti 11 dhe shkallët e hajatit

Ambienti 12 (Fig. 41);

Ky ambjent përdoret aktualisht nga banorët që jetojnë në shtëpinë e grave (bërthama 1).

- Dritarja e këtij ambienti është e re, ajo është zgjeruar, nga 95cm që ka qenë në rilevimet e 1979 në 150cm aktualisht.
- Ambienti duket në gjendje të mirë.
  - Do të bëhet meremetimi dhe lyster me sherbet gëlqereje. Si dhe pastrim të derës dhe dritares së drurit, lyster me vaj lini dhe anti molë.
  - Revizionimi i instalimeve elektrike.




Figura 46. Kati i parë, bërthama 2, ambienti 12

Ambienti 13 (Fig. 42);

Ky ambient, oborr, është krijuar në vitet 60, mbasi është bërë ndarja me mur qerpiçi i oborrit të jashtëm të banesës nga banorët e shtëpisë duke ndarë banesën me dy hyrje, një për secilën familje.

- Muri ndarës pjesërisht prej çerpiçi dhe pjesërisht prej duri (ndërrhyrje të mëvonëshme), nga ana e brendëshme e këtij ambienti është në gjedje shumë të keqe duke qenë se nuk është mirmbajtur dhe suvatur nga pronarët. Ana e jashtme e tij është relativisht e mire dhe e suvatur e lyer me gëlqere. Elementet e brezave prej druri në muraturë janë të degraduar dhe një pjesë e tyre mungojnë, kjo ka shkaktuar edhe degradimin e këtij muri.
- Do të bëhet restaurimi dhe plotësimi i brezave prej druri përgjatë gjithë perimetrit të këtij muri. Do të bëhet çmontim i pjesëve të dëmtuara (si me gur ashtu edhe me tulla balte) dhe do të ri montohet sërish me tulla baltë. Pas restaurimit të murit do të realizohet suvatimi me llaç balte (shiko specifikimet teknike për realizimin e tullave prej balte) dhe lyerjen me sherbet gëlqereje. Do të realizohet revizionim imbulesës me tjegulla.
- Muri i jashtëm, në pjesën që lidhet me banesën, faqja nga ana e brendëshme, është realizuar me beton, një ndërrhyrje e konsideruar shumë e gabuar.
  - Do të priset pjesa e betonit me kujdes duke ruajtur muraturën dhe do të rindërtohet me gurë duke e lidhur me faqen e jashtme.

- Muri i jashtëm, dhe porta origjinale e banesës, që realizon hyrjen në këtë ambient është mbuluar me solet betoni.
  - Do të priset soleta e betonit dhe do të ndërtohet një çati 2 ujse me strukturë druri mbuluar me tjegulla vendi (si në dokumentacionin fotografik në arkivën e IMK-së, të viti 1979).
- Një tjetër ndërhyrje e gabuar, është edhe suvatimi që i është bërë murit të jashtëm në të dyja anët e portës me llaç çimento duke imituar një muraturë me gur të rregullt dhe është lyer me gëlqere. Teknik kjo e pa përdorur në zonën e Zerqanit (fig.43).
  - Do të bëhet pastrimi i fugave dhe i gurëve nga gëlqeria, në mënyrë mekanike (Fig. 25).
- Dera prej druri është në gjedje të keqe, kjo si rezultat i mos mirmbajtjes nga banorët (Fig. 43).
  - Do të bëhet restaurimi i derës, duke e pastruar, zvendësuar elementet e kalbur dhe do të trajtohet me vaj lini dhe solucion anti mole.
- Çezma e realizuar me mjeshtëri, me mur guri të skuadruar dhe me dopio hark formë lundre, është një element me vlerë për kompleksin e banimit. Ajo ka qenë ndërtuar në funksion të tyrbes. Aktualisht nuk është funksionale.
  - Mendojmë që do ishte një element shumë i rëndësishëm për tu rikthyer në punë si çezëm dhe për këtë duhet realizur furnizimi i saj me uji të pishëm që fare mirë mund të merret nga çezma që ndodhet rreth 18m largë saj, afër rrugës automobilistike. Gjithashtu do të realizohet edhe një kanal drenazhi i cili mund të lidhet me ambjentin e tualetit nr.11.
- Si rezultat i tretjes nga ujërat e shiut që bien në murin prej qerpiçi të pa suvatuar mbi çesëm ka bërë tretjen e tullave prej balte, si rezultat edhe veshjen e gurëve të skuadruar të çesmës me një shtres dheu të kuq (Fig.43).
  - Do të bëhet pastrimi i gurëve nga kjo shtres në mënyrë mekanike, me furçë dhe uji. Do të bëhet pastrimi i fugave nga llaçi i çimentos dhe ri fugatimi i tij me llaç gëlqere.



Figura 47. Kati i parë, bërthama 2, ambienti 13



Figura 48.Kati i parë, bërthama 2, ambienti 13

Ambienti 14 (Fig. 44);

Tyrbja ka qenë pjesë përbërëse e kompleksit të banimit, e restauruar në vitin 1990. Aktualisht tyrbja është funksionale dhe vizitohet nga besimtarë të zonës. Brenda saj janë të vendosura dhe 4 varre të Shehllervë të brezave të ndryshëm të familjes Shehu.

- Ky ambient duket të jetë në gjendje të mirë konstruktive.
  - Do të realizohet hiroizolimi nga jashtë, në brezin e poshtëm, dhe me konkretisht nga ana lindore, jugore dhe perëndimore për të larguar infiltrimin e ujërave në muratur. Do të realizohet suvatimi i murit jugor dhe perëndimor me laç gëlqere, dhe do të lyhet me sherbet gëlqere. Objekti ka nevojë edhe për një revizionim të çatisë.



Figura 49.Kati i parë, bërthama 2, ambienti 14

Ambienti 15 (Fig. 45);

Oborri i jashtëm i banesës së burrave, pas ndërrimit të murit ndarës midis këtij ambienti dhe atij me nr.13, është hapur një portë e re në murin rrethues në krahun jugor. Pronarët e kësaj pjesë të banesës vitet e fundit e kanë zgjeruar këtë portë nga ana lindore duke e bërë të përshatshme për kalimin e makinave.

- Nga sa u verifikua në vend, porta prej druri ka nevojë për restaurim.
  - Mbulesa e saj me çati konstrukcion druri dhe tjegulla është në gjendje të mirë, megjithatë do të bëhet një revizionim çatie. Shpatullat e portës të suvatuara do të meremetohen me laç gëlqere dhe do të lyhen me sherbet gëlqere.
- Muri rrethues duket në gjendje të mirë konstruktive.
  - Muri midis portës dhe tyrbes nga ana e lulishtes duket në gjendje të mirë konstruktive por aktualisht është i suvatur vetëm me shtresën e parë të suvasë. Muri do të suvatohet me laç gëlqere dhe do të lyhen me sherbet gëlqere.
  - Do të bëhet revizionim i mbulesës me tjegulla.



Figura 50. Bërthama 2, oborri i jashtëm

Ambienti 16 (Fig. 45);

Ky ambient është një nyje sanitare e ndërtuar në vitin 1990 sipas projekti të hartuar dhe miratuar nga IMK (Fig. 21). Pasi është ndërtuar një nyje tjetër sanitare në krahë të këtij ambjenti mbuluar me llamarinë të viaskuar. Ky ambient nuk është përdorur me dhe aktualisht është në gjendje shumë të keqe.

- Do të bëhet prishja e kërrij ambjenti si dhe ndërtimi i një çatie një ujëse mbi tualetin e ri.

**Kati i dytë (bërthama 2)**



Figura 51. Kati i dytë, bërthama 2

Ambienti 1 (Fig . 47);

- Ambienti 1 ose çardaku i banesës është i shtruar me një shtresë llustër çimento.
  - Do të realizohet heqja e kësaj shtrese dhe shtrimi me pllaka guri të skuadruara në ngjyre gri.

- Nga sa mund të shikohet në vend struktura drusore e këtij ambienti, kolonat, shkallët e drurit dhe trarët e tavanti janë në gjendje relativisht të mire.
  - Do të realizohet trajtim profesional me anti-insekticid dhe vaj lini i kësaj strukture.
- Suvaja murale e këtij ambienti duket në gjendje të mire.
  - Do të realizohet meremetimi i suvasë ku është e nevojëshme me llaç gëlqere (dukeqenë se aktualisht është e suvatur me llaç gëlqere) dhe sherbetosje me sherbet gëlqere.
  - Revizioni i instalimeve elektrike.



Figura 52. Ambient 1, çardaku.

#### Ambienti 2-3;

- Ambienti 2 dhe 3 i banesës është relativisht në gjendje të mirë konstruktive.
  - Në këto ambiente do të realizohet meremetim i murit ku është i nevojëshëm si dhe lyerje me sherbet gëlqere.
  - Të gjitha strukturat drusore, si tavani, dyshemeja dhe dollapër e murit do të pastrohen, lyhen me vaj lini dhe antimolë.

- Dritaret e vendosura gjat restaurimit të viti 2007 aktualisht janë në gjendje jo të keqe por me zore hapen, si rezultat i drurit të pishës jo të stazhionuar. Do të behet restaurimi i tyre dhe trajtimi me anti mole dhe vaj lini.
- Do të behet restaurimi i dyerve, lyerja me anti mole dhe vaj lini.
- Do të bëhet edhe pastrimi i oxhakëve në mënyrë që të jenë funksional.
- Revizioniimi i instalimeve elektrike.

Ambienti 4 (Fig . 48);

- Ky ambient është në gjendje të mirë konstruktive
  - Në këtë ambiente do të realizohet meremetim i murit ku është i nevojshëm si dhe lyerje me sherbet gëlqere.
  - Të gjitha strukturat drusore, si tavani, dyshemeja dhe dollapër e murit do të pastrohen, lyhen me vaj lini dhe antimolë.
  - Dritaret e vendosura gjat restaurimit të viti 2007 aktualisht janë në gjendje jo të keqe por me zore hapen, si rezultat i drurit të pishës jo të stazhionuar. Do të behet restaurimi i tyre dhe trajtimi me anti mole dhe vaj lini.
  - Do të behet restaurimi i dyerve, lyerja me anti mole dhe vaj lini.
  - Do të bëhet edhe pastrimi i oxhakëve në mënyrë që të jenë funksional.
  - Revizioniimi i instalimeve elektrike.



Figura 53. Ambient 4, majtas- pamje e qoshkut, djathtas- ndarja e mbjentit me fibër realizuar në 1980.

#### Ambienti 5;

Ambienti me nr.5 është në gjendje relativisht të keqe dukeqenë se nuk ka jetuar njëri për një periudhë të gjatë kohore. Aktualisht është i pa banueshëm. Ndërhyrjet që do të kryhen në këtë ambjen janë;

- Pastrimi nga suvaja me qull gëlqere i muraturës, dhe risuvatimi i tij me po të njëjtin material dhe teknik, qull gëlqere të stazhionuar mbi 10 vjet, lesh dhie dhe të bardhe veze.
- Pastrimi i suvasë së tavanit me listela druri dhe risuvatimi i tij me llac gëlqere dhe lyerje me sherbet gëlqere.
- Zvendësimi i të gjitha dritareve prej druri me dritare të reja prej druri të stazhionuar me të njëjtin konfiguracion, të trajtuara me vaj lini dhe anti molë.
- FV dyer druri të trajtuara me vaj lini dhe anti molë.
- Restaurim i dyshemes prej druri trajtuara me vaj lini dhe anti molë.
- Restaurim i WC me veshje dërrase të stazhionuar, si dhe FV tualet dhe lavaman, instalime hidraulike në mënyrë të që ri vihet në funksion ky ambjent.
- Instalime elektrike.

#### Ambienti 6;

Ambienti me nr.6 është në gjendje relativisht të keqe dukeqenë se nuk ka jetuar njëri për një periudhë të gjatë kohore. Aktualisht është i pa banueshëm. Ndërhyrjet që do të kryhen në këtë ambjen janë;

- Pastrimi nga suvaja me qull gëlqere i muraturës, dhe risuvatimi i tij me po të njëjtin material dhe teknik, qull gëlqere të stazhionuar mbi 10 vjet, lesh dhie dhe të bardhe veze.
- Pastrimi i suvasë së tavanit me listela druri dhe risuvatimi i tij me llaç gëlqere dhe lyerje me sherbet gëlqere.
- Zvendësimi i të gjitha dritareve prej druri me dritare të reja prej druri të stazhionuar me të njëjtin konfiguracion, të trajtuara me vaj lini dhe anti molë.
- FV dyer druri të trajtuara me vaj lini dhe anti molë.
- Restaurim i dyshemes prej druri trajtuara me vaj lini dhe anti molë.
- Instalime elektrike.

#### Ambienti 7( Fig.39);

Çardaku aktualisht është në gjendje të keqe konstruktive.

- Dukeqenëse struktura e drurit të tij (trearër, kolonat parmakër dhe dysHEMEJA) është nën efektin shkatërrues të agjentëve atmosferik. Ka bërë që kjo struktur drusore ta humbas totalisht funksionin mbajtës duke u bërë i pa qëndrueshëm. Pronarët janë munduar të përforcojnë strukturën mbantëse me puntela druri por me kalimin e kohës struktura e tavanit, trarët janë kalbur dhe janë në rrezik shëmbje.
  - Do të bëhet çmontimi i kësaj strukture, dhe ri bërja e saj duke përdorur të gjitha elementët origjinal në gjendje të mirë dhe duke zvendësuar ato që janë jashtë funksionit me dru lisi të stazhionuar dhe trajtuar me anti mole dhe vaj lini.
- Suvaja e mureve në këtë ambient është në gjendje të keqe dhe ka nevojë të ribëhet
  - Pasi të pastrohen muret nga suvaja ekzistuese do të bëhet suvatim i ambientit me llaç-qull gërqereje të stazhionuar mbi 10 vjet, lesh dhie dhe tw bardhe veze.
  - Do të bëhen instalimet elektrike.

Ambienti 8 (Fig. 49);

Ky ambiente është në gjendje shumë të keqe dhe i pa banueshme. Ndërhyrjet që do të realizohen në këto ambiente do të jenë;

- Zhveshja nga suvaja me llaç çimento (pjesa e ngelur) dhe ajo me qull gëlqere i muraturës, dhe risuvatimi i tij me qull gëlqere të stazhionuar mbi 10 vjet, lesh dhie dhe tw bardhe veze.
- Hapja e tamponimeve të dritareve në fasadën jugore të dhonës dhe vendosja e dritareve të reja (arkitarrëve dhe paramakëve) prej druri të stazhionuar me të njëjtin konfiguracion si në dokumentacionin grafik të IMK-së, trajtim i tyre me vaj lini dhe anti molë.
- Mbyllja e hapjeve, dritareve të realizuara në fasadën veriore të ambientit me tulla balte (shiko specifikimet për realizimin e tullave prej balte) dhe restaurimi i murit prej qerpiçi.
- FV dritare druri të trajtuara me vaj lini dhe anti molë.
- Çmontim i tavanit të degraduar, ri bërje e tij me të njëjtin konfiguracion, me dru të stazhionuar.
- Pastrim i dyshemes me llaç horasan dhe revizionim i strukture së drurit, shtrim me dhoga druri me ndërthurje femer - mashkull.
- Realizimi i instalimeve elektrike.



Figure 54. Ambient 8, majtas- suva me llac cemento

Ambienti 9 (fig. 50);

Ky ambiente është në gjendje të keqe dhe i pa banueshme. Ndërhyrjet që do të realizohen në këto ambiente do të jenë;

- Meremetim i suvasë dhe lyerja me sherbet gëlqere i të gjithë ambientit, muratur dhe tavan.
- F.V dritare druri të trajtuara me vaj lini dhe anti molë.
- Restaurim i dysheve prej druri si dhe trajtimi me vaj lini dhe anti molë.
- Restaurim i derës dhe trajtimi i saj me anti mole dhe vaj lini.
- Realizimi i instalimeve elektrike.



Figure 55. Ambient 9

Ambienti 10 (fig. 51-52-53);

Ky ambjente është në gjendje të keqe dhe i pa banueshme. Ndërhyrjet që do të realizohen në këto ambjente do të jenë;

- Çmontimi i tavanit të degraduar, (me listela druri dhe suva), dhe rindërtimi i tij me po të njëjtën teknikë dhe material si ai ekzistuesi.
- Çmontim i dritares ekzistuese.
- Restaurim i murit të qerpiçit në fasadën jugore dhe mbyllja e dritares në këtë fasadë duke lënë dy dritare të vogla (si në dokumentacionin grafik të arkivës së IMK-së). Restaurimi do të bëhet me tulla balte dhe breza druri të stazhionuar (shiko specifikimet për realizimin e tullave prej balte).
- F.V. dritare druri me të njëjtin konfiguracion si në dokumentacionin grafik të arkivës së IMK-së.
- Restaurimi i murit të qerpiçit në fasadën veriore dhe tamponimi i hapjeve të mëvonëshme në këtë fasadë me tulla balte dhe breza druri (shiko specifikimet për realizimin e tullave prej balte).
- Zhveshja nga suvaja e degraduar i muraturës, dhe risuvatimi i tij me qull gëlqere të stazhionuar mbi 10 vjet, lesh dhie dhe tw bardhe veze.
- F.V. dyer druri të trajtuara me vaj lini dhe anti molë.
- Çmontim i tavani të degraduar, ri bërje e tij me të njëjtin konfiguracion, me dru të stazhionuar.
- Pastrim- restaurim i dyshemes prej druri, trajtim i saj me anti mol dhe vaj lini.
- Restaurim i dollapit të murit dhe vendosja e kapakëve prej druri.
- Restaurimi i shkallëve prej druri që të çojnë në këtë ambjen.
- Zhveshja nga suvaja e degraduar i muraturës në ambjentin e shkallëve, dhe risuvatimi i tij me qull gëlqere të stazhionuar mbi 10 vjet, lesh dhie dhe tw bardhe veze.
- Restaurim i murit prej qerpiçi dhe F.V dritare druri në fasadën veriore në ambjentin e shkallëve.
- Realizimi i instalimeve elektrike.



Figura 56. Ambient 10



Figura 57. Ambient 10, majtas- dollapi i murit, djathtas- muri i degraduar dhe hapjet në fasadën veriore



Figura 58. Ambient 10, ambjenti i shkallëve

**KATI PËDHE (BËRTHAMA 1)**




Figura 59. Plani i katit përdhe, bërthama 1 (shtëpia e grave)

Ambienti 4-5-6-7;

Këto ambiente aktualishtë përdoren si katua për kafshët.

- Muratura e këtij kati është prej guri të pa përpunuar.
  - Do të bëhet fugatim me llaç gëlqereje nga brenda si dhe restaurimi i paretit jugor të ambjentit nr. 5 me teknikën, shqep-qep;
- Struktura e tavanit, trarët dhe pjesa e shtresës prej drurësh të pa përpunuar duken në gjendje të mire, aktualishtë banorët e kanë lyer me sherbet gëlqere për të mbajtur insektet largë;
- Dyert prej druri janë të amortizuara
  - Do të bëhet heqja e tyre dhe zvendësim me dyer të reja druri të stazhionuar me të njëjtin konfiguracion.

#### **KATI I PARË (BËRTHAMA 1)**

Bërtham 1 apo shtëpia e grave është edhe ndërtimi më i hershëm i kompleksit të banimit. Aktualishtë kjo banesë është e ndarë në dy hyrje të ndryshme dhe është pjesërishtë e banuar nga një familje, pasadhesit e familjes Shehu. Nga krahasimi që mund të bëjmë planimetrisë së banesës, nga rilevimet e 1979 dhe gjendjes ekzistuese mund të shikohet qartë se banesa ka pësuar disa ndërhyrje dhe transformime në planimetri. Këmi ndarje të dhomës së zjarrit në dy ambjentë. “Hajati” i banesës tani është mbylluta dhe është kthyer në dhomë. Nyjet sanitare janë të pozicionuara në fasadën veri-perëndimore të banesës. Dhoma me qoshk (ambienti 4) është funksionale. Pozicionimi i saj është pak sa më e mbrojtur së ajo e burrave që është pozicionuar në një vend dominues në fasadën lindore të banesës.




Figura 60. Plani i katit të parë, bërthama 1 (shtëpia e grave)

Ambienti 1(Fig. 56);

Ky ambient ka qenë i hapur në formen e një hajati. Aktualishtë është i mbyllur me vetrat druri gjith fasada jug-lindore dhe shfrytëzohet si dhomë ndënjtieje nga banorët. Përgjithësishtë është në gjendje të mirë konstruktive. Ambienti është shtruar me një shtresë llustër çimento. Nërhyrjet që do të realizohen në këtë ambient janë:

- Do të realizohet shtrimi i këtij ambjenti me dysheme me dhoga druri të stazhionuara dhe trajtuar me antimol dhe vaj lini, me teknikën e ndërthurjs (duke qënë se nuk ka konstruksion ku të gozhdohen dërrasat e dyshemes propozohet vendosja e dërrasave me ndërthurje femër mashkull).
- Restaurim i vetratës prej druri dhe xhami duke ruajtur elementin origjinal të parmakit të hajatit në krahun e djathtë të hyrjes (detaj ky, që shihet edhe nga fotografit e arkivit të IMK-së realizuar në 1979 kur hajati ka qen i hapur).
- Stukim i suvasë ku do të jet i nevojëshëm si dhe lyerje me sherbet gëlqereje.



Figura 61. Ambienti 1 (berthama 1)

Ambienti 2(Fig. 57);

Ky ambient mendohet të ket qenë një me ambientin 3. Në restaurimin e viteve 1979-81 muret e këtij ambienti në krahun jugor dhe perëndimor të tij janë rindërtuar. Aktualishtë është në

gjendje të mirë konstruktive. Ambienti është shtruar me një shtresë llustër çimento. Nërhyrjet që do të realizohen në këtë ambient janë:

- Do të realizohet shtrimi i këtij ambjenti me dysheme me dhoga druri të stazhionuara dhe trajtuar me antimol dhe vaj lini, me teknikën e ndërthurjs (duke qënë se nuk ka konstruksion ku të gozhdohen dërrasat e dyshemes propozohet vendosja e dërrasave me ndërthurjefemër mashkull).
- Trajtimi i dritares dhe derës me vaj lini dhe anti mole
- Stukim i suvasë ku do të jet i nevojëshëm si dhe lyerje me sherbet gëlqereje.



Figura 62. Ambienti 2 (berthama 1)

Ambienti 3(Fig. 58);

Ky ambient mendohet të ket qenë një me ambientin 4. Aktualishtë është në gjendje të mirë konstruktive. Ambienti është shtruar me një shtresë llustër çimento. Këtij ambjenti në ndërhyrjet restauruese të viti 1979-81 i është hapur një derë në fasadën veri-perëndimore për të realizuar komunikimin e kësaj banesë me tualetet. Nërhyrjet që do të realizohen në këtë ambient janë:

- Do të realizohet shtrimi i këtij ambjenti me dysheme me dhoga druri të stazhionuara dhe trajtuar me antimol dhe vaj lini, me teknikën e ndërthurjs (duke qënë se nuk ka

konstruktion ku të gozhdohen dërrasat e dyshemes propozohet vendosja e dërrasave me ndërthurjefemër mashkull).

- Restaurim, trajtimi i dritares dhe derës me vaj lini dhe anti mole.
- F.V derë druri (dera që është me fibër).
- Stukim i suvasë ku do të jet i nevojshëm si dhe lyerje me sherbet gëlqereje.



Figura 63. Ambienti 3 (berthama 1)

Ambienti 4(Fig. 59);

Ky ambient mendohet të ket qenë një me ambientin 3. Ky ambienti është shumë i veçant nga gjith ambjentet e tjer të kompleksit, përveç dritareve në fasadaën veri-perëndimore (të cilat kanë qenë të vogla në dimensione 65 cm gjerësi, të pa mjaftueshme për të ndriçuar ambientin e madh të kësaj dhome) ambienti ndriçohet edhe nga 3 dritare të tjera me dalje në çati po nga nga krahu veri-perëndimor. Aktualisht ky ambient është në gjendje të mirë konstruktive. Ambienti është shtruar me një shtresë llustër çimento. Këtij ambjenti në ndërhyrjet restauruese të viti 1979-81 i është bërë zgjerimi i 3 dritareve në fasadën veri-perëndimore. Banorët kanë

bërë edhe mbylljen e pjesës së poshtme të oxhakut dhe kanë vendosur sobë më dru me dalje për tymrat në vendin e oxhakut. Nërhyrjet që do të realizohen në këtë ambient janë:

- Do të realizohet shtrimi i këtij ambjenti me dysheme me dhoga druri të stazhionuara dhe trajtuar me antimol dhe vaj lini, me teknikën e ndërthurjs (dukeqënëse nuk ka konstruksion ku të gozhdohen dërrasat e dyshemes propozohet vendosja e dërrasave me ndërthurjefemër mashkull).
- Restaurim, trajtimi i dritares, dollapëve të murit dhe derës me vaj lini dhe anti mole.
- Stukim i suvasë ku do të jet i nevojshëm si dhe lyerje me sherbet gëlqereje.



Figure 64. Ambienti 4 (berthama 1)

Ambienti 5-6-7(Fig. 60);

Ambienti nr.5 mendohet të ket qënë një me ambientin 2. Në restaurimin e viteve 1979-81 muret e këtij ambjenti në krahun jugor dhe perëndimor të tij janë rindërtuar. Aktualishtë ambientet 5,6 dhe7 janë në gjendje jo të mirë konstruktive. Ato janë shtruar me një shtresë llustër çimento pesha e të cilit mund të çoj deri në çedimin dhe rënien e strukturës mbajtëse të saj. Tavani me strukturë listelash druri dhe suva është i degraduar dhe një pjesë e madhe e suvas

ka rënë. Shkallët që të çonin në këtë banes tani nuk janë më (në rilevimet e 1979 struktura e tyre është e qartë). Dyert dhe dritaret prej druri janë degraduar me kalimin e kohës dhe si rezultat i përdorimit të materialit drusor jo të stazhionuar. Nërhyrjet që do të realizohen në këtë ambient janë:

- Pasi të jet hequr shtresa prej betoni në dysheme, do të realizohet nivelimi nëpërmjet shtrimit të këtyre ambienteve me një shtresë llaç çimento 5cm (me një zgarë metalike) mbi të cilin do të vendoset një shtresë hidroizoluese. Mbi këtë shtresë do të realizohet dysheme me dhogë druri të stazhionuara dhe trajtuar me antimol dhe vaj lini, me teknikën e ndërthurjes (duke qënë se nuk ka konstrukcion ku të gozhdohen dërrasat e dyshemes propozohet vendosja e dërrasave me ndërthurje femër mashkull).
- Zhveshja nga suvaja ekzistuese e muraturës, dhe risuvatimi i tij me llaç gëlqere të stazhionuar mbi 10 vjet, dhe lyerje me sherbet gëlqere.
- Restaurimi i dritareve prej druri dhe trajtimi me vaj lini dhe anti molë i tyre.
- Restaurim i tavani të degraduar, suvatim me llaç gëlqere dhe lyerje me sherbet gëlqere.
- F.V derë druri të trajtuar me anti molë dhe vaj lini.
- Restaurimi dhe trajtimi i të gjitha elementëve prej druri (tratë, kolona, arkitrarë, parmak, dhe dollape muri) me anti mole dhe vaj lini.
- Realizimi i instalimeve elektrike.



Figura 65. Ambienti 5-6-7 (berthama 1)

Ambienti 8 (Fig. 61);

Ky ambient që ka shërbyer si një sanitare, është pjesërisht i rrënuar. Nërhyrjet resaturuese që do të realizohen janë:

- Restaurimi i murit nga fasada lindore me teknikën shqep – qep.
- Restaurim i mureve prej çatmaje, muret ndarës.
- Resaturimi i tavanit me listela druri, suvatim i tij me llaç gëlqere dhe lyerje me gëlqere.
- Ri suvatim i ambjenteve me llaç gëlqere.
- F.V i paisjeve hirdo sanitare
- Realizimi i instalimeve hidraulike, furnizim me uji.
- Realizimi i sistemit të drenazhit.
- F.V dyer dritare druri.
- Installet elektrike.



Figura 66. Ambianti 8 (berthama 1)

#### NDËRHJRJE TË PËRGJITHËSHME

Ndërhyrjet kryesore të parashikuara për restaurimin e banesës së “Mustafa Shehu” synojnë së pari të sigurojnë qendrueshmerine e objektit, shoqëruar në çdo hap me ruajtjen dhe restaurimin e elementeve të trashëgimisë kulturore.

- Prishje e te gjitha shtresave prej betoni në oborrin e jashtëm.
- Çmontim çati;

- Konsolidimi me injektim i kreut të muraturës me llaç balte;
- Konsolidimi i kreut të muraturës me 1.2 cm llaç balte.
- Restaurim i brezit lidhës prej druri, nën çati.
- Restaurim i çatisë sipas teknikës së zonës, mulimi me tjegulla vendi.
- Restaurim i çarjeve në mur guri me teknikën e injektimit të llaçit të baltës.
- Prishje e shtresës së suvasë së degraduar dhe suvatim me llaç balte dhe sherbetosje me sherbet gëlqere i të gjitha fasadave.
- Suvatim me llaç gëlqere i fasadës jugore të bërthamës 3, ndërtim i viteve 1925-50.
- Restaurimi i të gjith elementëve drusor, brezave lidhës, plotësim i tyre ku është i nevojshëm, lyerje me anti insekticid dhe vaj lini.
- Fugatim i muraturës së gurit në katit përdhe jashtë.
- Shtrimi me kaldrëm i të gjithë oborrëv të kompleksit.
- Sistemi i tërritorit jash mureve rrethues.

#### 4. OBJEKTIVAT

Do të bëhet restaurimi si dhe konsolidimi i muraturës për të siguruar jetëgjatësinë e objektit njëkohësisht edhe eliminimi i shkaqeve që çon në degradimin e saj edhe krijimin e kushteve optimale për jetesë.

Përmirësimi i karakteristikave mekanike: tritje e rezistencës në shtypje dhe prerje.

Përmirësim i nivelit të organizimit të muraturës: nevojë për të përmirësuar qendrueshmërinë e muraturës si strukturës së mbështetimit, konsolidim i bërthamës së degraduar (brezave lidhës prej druri) dhe strukturave horizontale prej druri (konstrukcioneve të dysHEMEVE dhe tavaneve të drurit).

Qepje e çarjeve të evidentuara: stukim dhe qepja me injektim i çarjeve për të ristabilizuar vazhdimësinë e muraturës.

Realizimi i nevojave bazë të një banëse, instalimet elektrike, hidraulike dhe drenazhi i ujerave.

#### 5. DOKUMENTACIONI DHE BIBLIOGRAFIA:

- Arkiva IMK
- Akademia e shkencave e Shqipërisë, "Vendbanimet dhe Banesat popullore Shqiptare",
- Leonard Suli "Restaurimi i një kompleksi banimi në fshatin Zerqan të rrethit të Dibrës" revista Perla, fq. 15- 17.
- Sulejman Dashi "Teqetë e Shqipërisë: Aspekte të historisë dhe arkitekturës", Perla, nr.1, 1999, fq. 98-107.

Katerina  
Margariti

Digitally signed by  
Katerina Margariti  
Date: 2022.03.18  
10:10:50 +02'00'

Romir  
Mazari

Digitally signed by  
Romir Mazari  
Date: 2022.03.18  
11:20:06 +02'00'

Romir  
Mazari

Digitally signed by  
Romir Mazari  
Date: 2022.05.30  
10:17:20 +02'00'

Klodjana  
Gjata

Digitally signed by  
Klodjana Gjata  
Date: 2022.05.30  
12:59:58 +02'00'

Rudina  
Papavasi

Digitally signed by  
Rudina Papavasi  
Date: 2022.05.31  
11:49:41 +02'00'

Rudina  
Zoto

Digitally signed by  
Rudina Zoto  
Date: 2022.05.31  
16:41:00 +02'00'

